



Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit
Gusht 2020/ Nr. 8



Ministria e Mbrojtjes- UNDP
Fillon projekti për sistemin
e menaxhimit të fatkeqësive



Gjenerallejtënant Eric P. Wendt në Tiranë
Gjeneral brigade Kollçaku pret
komandantin e Forcave Speciale të NATO-s



Prezenca e Përparuar e Përforcuar e NATO-s
Kontingjenti VII, EOD nisët
në misionin e NATO-s, në Letoni



Shefi i FSK, Gjenerallejtënant Rrahman Rama në Tiranë

KOLLÇAKU-RAMA: Të intensifikohet plani i bashkëpunimit ushtarak midis FARSH-së dhe FSK-së

Përmbajtja

Numri 8

MINISTRJA XHAËKA

- 6** Qeveria akordon shtesë në pagën mujore, 10 mijë lekë për ushqimin

VIZITA

- 13** Gjeneral brigade Kollçaku pret komandantin e Forcave Speciale të NATO-s

KOMANDA MBËSHTETËSE

- 29** Kontingjenti VII, EOD niset në misionin e NATO-s, në Letoni

SHKOLLA E TRUPËS NË BUNAVI

- 27** Bunavi, betohen 116 ushtarët e rinj të Forcave të Armatosura

HISTORI

- 34** Në kuadrin e 100 vjetorit, lufta e Dibres 1920

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA

Saimir ALIJA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



4 EMERGJENCAT CIVILE

Fillon projekti për sistemin e menaxhimit të fatkeqësive

Me ftesë të ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni realizoi të premten që kaloi më 19 qershor 2020, vizitën...



10 TAKIMI

Kollçaku-Rama: Të intensifikohet plani i bashkëpunimit ushtarak midis FARSH-së dhe FSK-së

Me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneralletënant Rrahman Rama...



14 EMËRIMI

Gjeneralmajor Bajram Begaj, merr detyrën si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, dekretuar me 29 korrik nga Presidenti Ilir Meta, njëkosisht...



29 AFA

"Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura

Zhvillimi i fushave thelbësore të shoqërive moderne ka çuar në ndryshime të rëndësishme në fushën e sigurisë. Kështu, elementi ushtarak u kërkohet...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 88-të i botimit
Nr. 8/ 2020

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Fillon projekti për sistemin e menaxhimit të fatkeqësive

Shqipëria drejt anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit European

Modernizimi i Emergjencave Civile po vijon me pajisjen e këtyre strukturave me bazë logjistike, të nivelit të parë të standardeve më të mira ndërkombëtare.

Kryeministri Edi Rama ndau ditën e shtunë më 18 korrik 2020, disa foto nga pajisjet e reja dhe stërviçja në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare.

“Vijon modernizimi i forcës sonë të Emergjencave Kombëtare, të cilat po plotësohen me një bazë logjistike të nivelit të parë dhe kanë nisur edhe stërviçjet në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare”, - tha Rama. Në muajin prill, Emergjencat Civile u pajisën me flotën e re të autoambulancave, të cilat erdhën nga Turqia.

Për mirësimin e sistemit të mbrojtjes civile, prej kohësh ka marrë vëmendjen dhe përkushtimin e ministrisë së Mbrojtjes dhe qeverisë shqiptare. Këtij qëllimi do t'i shërbejë projekti “Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri”, i cili u inagurua të premten që kaloi, më datë 17 korrik 2020, nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe përfaqësueses së përhershme të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Limya Eltayeb.

“Dokumenti që nënshkruam pak më parë, mbështetet në sugjerimet që ekspertë vendas dhe të Bashkimit European, Bankës Botërore dhe UNDP, dhanë në raportin e vlerësimit të nevojave, pas tërmetit të 26 Nëntorit të vitit të kaluar. Kurrë më shumë sesa në ato ditë të vështira, nuk ka qenë më i vyer mendimi i ekspertëve vendas e të huaj, për të përmirësuar Sistemin e Mbrojtjes Civile, mbështetur në koordinimin dhe bashkëpunimin institucional, në zhvillimin e kornizës që mundëson zvogëlimin e riskut



ndaj fatkeqësive natyrore, apo duke rritur kapacitetet përgatitore dhe reaguese të strukturave, dedikuar fatkeqësive natyrore në nivel qendror apo vendor.

Bazuar edhe mbi këtë projekt, do të mund të hartojmë kodet e reja të ndërtimit apo çka është më e rëndësishmja, do të realizojmë për herë të parë Vlerësimin e Riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar, e për rrjedhojë dhe strategjinë kombëtare për zvogëlimin e riskut të fatkeqësisë dhe procedurat standarde të operimit në rastet e fatkeqësisë. Sot, nisi puna për një projekt ambicioz, për të cilin ne në ministrinë e Mbrojtjes ndjehemi krenarë, pasi në pak vite, bashkë me ligjin e ri “Për Mbrojtjen Civile”, ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile,

forcimit të kapaciteteve të FA në kuadër të emergjencave civile, po hedhim gurët e themelit të një prej sistemeve më të rëndësishme, që mbron atë çka është më e shtrenjtë për secilin prej nesh: “jetën”, - deklaroi ministrja Xhaçka.

Aktualisht, UNDP po vë në zbatim dy iniciativa pilote në nivel qendror dhe vendor, përkatësisht vlerësimin e kapaciteteve institucionale, ku përfshihen institucionet e rëndësishme qendrore dhe bashkëpunimi me bashkinë e Lezhës për të zhvilluar profilin e saj të riskut dhe planin vendor të Mbrojtjes Civile, duke mundësuar kështu terrenin për një përshkallëzim të përpjekjeve të gatishmërisë dhe të përgjigjes.

“Fatkeqësitë natyrore kanë fuqinë që të përmbysin rritjen ekonomike



dhe progresin e arritur, të rrisin pabarazinë e ekspozimit ndaj risikut dhe të godasin më rëndë ata që kanë vështirësi më të mëdha ekonomike dhe sociale. Fatkeqësitë natyrore kanë qenë dhe vijojnë të jenë pjesë e realitetit tonë dhe pashmangshmërisht do të kemi një përkeqësim të mëtejshëm të këtyre fenomeneve nga ndryshimet klimatike. Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë lidhet me mbrojtjen e jetëve njerëzore, me varfërinë, bizneset dhe mjetet e jetesës për ne dhe brezat e ardhshëm. Në cilësinë e saj, si një organizatë botërore për zhvillim, UNDP promovon qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat kanë në qendër të tyre qeniet njerëzore nën moton "Askush të mos mbetet pas". Qëndrueshmëria ka nevojë për aftësi ripërtëritëse. Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë është mënyra e vetme për të garantuar se fatkeqësitë natyrore, nuk do ta nxjerrin zhvillimin e qëndrueshëm nga binarët. E për rrjedhojë, ne kemi vetëm një mundësi: të përgatitemi për të zbutur ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe, kur ato të ndodhin, të jemi të aftë të përgjigjemi në kohë për të shpëtuar sa më shumë jetë. Nëse vihet plotësisht në zbatim, ne jemi besimplotë se ky program do të shënjojë një pikë kthese në Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Shqipërinë". - u shpreh znj. Limya Eltayeb, përfaqësuese e përhershme e UNDP.

Projekti do të mbështesë

gjithashtu përpjekjet e Shqipërisë, për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian,, në pajtim me parimet e Kuadrit të Sendait për

Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë (KSRRF) dhe me rekomandimet e Vlerësimit të Nevojave pas Fatkeqësisë Natyrore (VNFN) në vazhden e tërmetit të 26 Nëntorit në Shqipëri.

MODERNIZIMI I EMERGJENCEVE CIVILE

Bazë logjistike me standardet më të mira ndërkombëtare

Modernizimi i Emergjencave Civile po vijon me pajisjen e këtyre strukturave me bazë logjistike, të nivelit të parë të standardeve më të mira ndërkombëtare. Kryeministri Edi Rama ndau ditën e shtunë ne me 18 korrik 2020, disa foto nga pajisjet e reja dhe stërvitja në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare.

"Vijon modernizimi i forcës sonë të Emergjencave Kombëtare, të cilat po plotësohen me një bazë logjistike të nivelit të parë dhe kanë nisur edhe stërvitjet në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare",- tha Rama. Në muajin prill, Emergjencat Civile u pajisën me flotën e re të autoambulancave, të cilat erdhën nga Turqia.



Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka: Qeveria akordon shtesë në pagën mujore, 10 mijë lekë për ushqimin

Çdo investim në armë e sisteme do të kishte qenë i mangët nëse nuk do të ishte shoqëruar me përpjekjen për të investuar tek burimet njerëzore të FA.

Duke nisur nga muaji korrik, mijëra ushtarakë shqiptarë do të kenë çdo muaj në pagën e tyre, një shtesë prej 10.000 lekësh, si kompesim për ushqimin. Lajmin pozitiv, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka e dha më 14 korrik 2020, gjatë takimit me efektivet e kontingjentit të Policisë Ushtarake, të cilët nisen për në Afganistan, ku do të shërbejnë në misionin e NATO-s, Resolute Support.

“Çdo investim në armë e sisteme do të kishte qenë i mangët nëse nuk do të ishte shoqëruar me një përpjekje po aq serioze e të qëndrueshme për të investuar tek burimet njerëzore të FA. Unë sot jam e lumtur t’ju jap një tjetër lajm të mirë në këtë drejtim. Për një vendim të propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, që ka gjetur mbështetjen e menjëhershme të qeverisë e kryeministrit Rama, i cili i jep një zgjidhje dinjitoze një problemi të mbartur prej shumë vitesh. Miratimi prej 10.000 lekësh (100.000 lekë të

vjetra) si shtesë në pagat mujore të ushtarakëve nuk është thjesht një zhvillim me impakt të konsiderueshëm pozitiv në buxhetet familjare të ushtarakëve, por edhe një shenjë vlerësimi për punën tuaj të jashtëzakonshme gjatë këtyre viteve duke e bërë FA institucionin më të besuar për shqiptarët.” - u shpreh ministrja Xhaçka. Sipas vendimit të Këshilli i Ministrave, të datës 10 Qershor 2020, ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura gëzojnë të drejtën e kompensimit financiar në vlerë në lekë, për trajtimin me ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas vendimit nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektive ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për ditët efektive të punës. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi mbi 8 orë, trajtohen me ushqim të gatuar ose kompensohen në vlerën në lekë të këtij



ushqimi, aty ku nuk është i mundur ofrimi i këtij shërbimi, sipas normës së përcaktuar në vendimin nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Përzgjedhja e formës së trajtimit me ushqim ose e kompensimit në vlerë në lekë për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, sipas pikës 6, të këtij vendimi, përcaktohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në bazë të kostos së ushqimit të gatuar dhe të vlerës kalorike të përcaktuar në vendimin nr.88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.524, datë 30.7.2004, "Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr.668, datë 7.8.2013, "Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave "Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", shfuqizohen.

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Por nga vendimi i mësipërm i qeverisë, ushtarakët përfitojnë edhe kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet. Kështu ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura që, për shkak të detyrës, emërohet ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë ose me kredi nga Ministria e Mbrojtjes dhe kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk



ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet. Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë: 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të



tipit garsoniere, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë; 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë; 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë. Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet çdo vit, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit të Mbrojtjes. Ushtaraku

aktiv i Forcave të Armatosura, që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente: kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës; çertifikatën personale, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake; çertifikatën familjare, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake; kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar; vërtetimin përkatës se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes; vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes nuk kanë banesë në pronësi. Këto dokumente rifreskohen çdo vit. Gjatë vizitës së saj në Policinë Ushtarake, ministrja Xhaçka inspektoi mjediset e reja të ndalimit disiplinor, financim i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

"Bashkëpunimi dhe mbështetja nga aleatët, veçanërisht nga ata amerikanë, sidomos gjatë dy viteve të fundit ka qenë e jashtëzakonshme. Falë kësaj mbështetjeje ia kemi dalë të përforcojmë çdo element të FA, që nga logjistika e transporti, e deri tek mbulimi i territorit me radar, sisteme armatimi apo flota e helikopterëve "Black Hawk", që na jep sot disa kapacitete luftarake që as nuk i imagjinonim pak vite më parë. E sigurisht, nuk mund të mos përmend Bazën e Kuçovës, që nuk është thjesht një investim i jashtëzakonshëm në terma infrastrukture, logjistike e kapacitetesh ajrore, por edhe një afirmim i rëndësisë strategjike të Shqipërisë për Aleancën", - tha ministrja Xhaçka.

Turqia dhuron 1250 uniforma të reja për Emergjencat Civile

Strukturat e Emergjencave Civile, pjesë e Forcave të Armatosura do të jenë shumë herë më të mirëpajisura dhe më dinjitoze në përballimin e fatkeqësive natyrore. 1250 uniforma të reja, të cilat përbushin të gjitha standardet e sigurisë, u dhuruan nga qeveria turke për Forcat tona të Armatosura. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, ambasadori i Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yoruk si dhe drejtues të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka shprehu ditën e martë, më 28 korrik 2020, falënderimet më të thella për popullin dhe qeverinë turke, duke cituar edhe shprehjen "miku i mirë në kohë të vështira". Duke përmendur investimet e viteve të fundit në Forcat e Armatosura, ministria Xhaçka theksoi vëmendjen që i është dhënë modernizimit dhe riorganizimit të strukturave të Emergjencave Civile.

"Brenda pak ditësh mbushet plot një vit që nga momenti kur Kuvendi miratoi ligji për mbrojtjen civile, i cili solli një revolucion të vërtetë në formën e organizimit, në rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit, dhe në aftësinë tonë për të përballuar emergjencat. Sot, kur nuk është mbushur ende viti nga fillimi i punës për ngritjen e kësaj strukture kaq të rëndësishme, e them me krenari që ia kemi dalë të ngremë një strukturë vërtetë efikase, por ç'është më e rëndësishmja, edhe të pajisur me mjete nga më

Marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak përbëjnë një nga dimensionet më të rëndësishme të marrëdhënieve të veçanta të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë



modernet e profesionalet." - u shpreh zonja Xhaçka, e cila njoftoi pajisjen e mëtejshme të Emergjencave Civile, falë bujarisë së qeverisë turke. "Shumë punë është bërë edhe për rritjen e kapaciteteve në përballimin e emergjencave. Dhe miratimi i projektligjit do t'i hapë rrugë përthithjes së një fondi prej 2,3 milionë dollarësh, faza e dytë e grantit turk, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga Ministria e Mbrojtjes. Sepse ashtu si në fazën e parë të grantit të akorduar nga Turqia për Ministrinë e Mbrojtjes edhe ky fond do të përdoret në funksion të përballimit të emergjencave civile me

të cilat përballet vendi." "Duke filluar me 6 ambulancat moderne, që janë në fakt mini spitale lëvizëse të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme, që nga respiratorët, kompletet e imobilizimit për frakturat apo edhe shumë aparatura të tjera për ndihmë të parë të specializuar, të adhura nga Turqia", - theksoi Xhaçka e cila shtoi se: "Duke vazhduar me rritjen e kapaciteteve për shuarjen e zjarreve, pajisjet për heqjen e ujërave pas përmytjeve, mbi 100 çadra me sipërfaqe nga 25 deri në 100 metra katrorë, e deri tek 1250 uniformat e reja të brenduara me logon e Forcave të Armatosura dhe

Emergjencat Civile, nga ku 500 palë uniforma të posaçme kundër shiut, 400 palë kundër zjarreve në pyje, që janë një nga sfidat tona të përvitshme, 250 palë uniforma kërkim shpëtimi dhe 100 uniforma për zjarrefikës profesionistë". Ambasadori i Turqisë në vendin tonë Murat Ahmet Yoruk, vlerësoi marrëdhëniet mes dy popujve dhe nënvizoi se vlera e mjeteve, pajisjeve dhe uniformave të reja të dhuruara nga qeveria turke arrin në 1,5 milionë dollarë amerikanë. "Menjëherë pas tërmeteve në muajt shtator dhe nëntor të vitit të kaluar dhe gjatë pandemisë së COVID-19, me udhëzime të Presidentit tonë të gjithë institucionet përkatëse u vunë në gadishmëri dhe u nxituan për të ndihmuar vëllezërit tanë shqiptarë. Qoftë me pjesëmarrjen e ekipeve të kërkim shpëtimit që operuan direkt në terren, qoftë edhe me qendrën e menaxhimit të emergjencave të fatkeqësisë natyrore, Ministrisë së Shendetësisë, Agjencinë TIKA dhe Gjysëm Hënës së Kuqe, ne kemi nxituar për të ofruar ndihmat më imediate dhe njëkohësisht për të mjekuar sado pak plagët e shkaktuara", - tha Yoruk.

Duke folur për marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve, ambasadori Yoruk theksoi: "Marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak përbëjnë një nga dimensionet më të rëndësishme të marrëdhënieve të veçanta të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë. Në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ushtarak, ne që prej afro 25 vitesh arrijmë të ofrojmë kontributin tonë për Forcat e Armatosura Shqiptare, aleates tonë në NATO".

"Njëkohësisht ne vazhdojmë punën dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes për të bërë të mundur rritjen e kapaciteteve të forcave civile në një afat të mesëm dhe afat të gjatë. Në këtë kontekst ne sot i dorëzojmë vëllezërve shqiptarë 6 autoambulanca tërësisht të kompletuara, 400 uniforma zjarrfikse, 500 uniforma që do të përdoren gjatë operacioneve të fatkeqësive natyrore të përmytjeve, 100 uniforma speciale zjarrfikse, 250 uniforma të ndryshme për kërkim shpëtimit dhe 160 çadra të llojeve të ndryshme. Vlera e të gjithë këtyre materialeve dhe pajisjeve kap shifrën 1,5 milionë dollarë", - përfundoi Yoruk.

Me anijen "Butrinti P-134", e cila ka marrë pjesë në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje

Ambasadorja Yuri Kim viziton Bazën Detare të Pashalimanit

Po vlerësohet mundësia me NATO-n që Baza Detare e Pashalimanit të modernizohet dhe të transformohet në një projekt model

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe ambasadorja amerikane Yuri Kim kanë vizituar më 10 korrik 2020, Bazën Detare të Pashalimanit si dhe kanë kryer dhe një udhëtim të shkurtër me anijen Butrinti përgjatë Gjirit të Vlorës. Sa i përket Bazës së Pashalimanit, Xhaçka zbulon se po vlerësohet mundësia me NATO-n që të modernizohet dhe të transformohet në një projekt model. Ajo shton se Shqipëria bashkë me SHBA nuk ndajnë vetëm misione të rëndësishme operacionale, por edhe qëllime për modernizimin e FA.

"Me ambasadorën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Yuri Kim zhvilluam një vizitë në Bazën Detare të Pashalimanit, për të cilën bashkë me Aleancën po vlerësojmë mundësinë e modernizimit dhe transformimit në një projekt model të NATO-s. Me pas, një udhëtim i shkurtër në Gjirin e Vlorës u mundësua nga anija Butrinti P-134, e cila ka marrë pjesë disa herë në operacionin "Sea Guardian" të NATO-s në detin Egje duke shpëtuar me qindra emigrantë. Me aleatin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndajmë jo vetëm misione të rëndësishme në teatrot operacionale, por edhe qëllimin e përbashkët për modernizimin e Forcave tona të Armatosura", - shkruan ministria Xhaçka në facebook.



SHBA aleati ynë strategjik

Në vitet e fundit, 180 milionë USD asistencë për mbrojtjen

Modernizimi i Forcave të Armatosura, për të qenë një aleat i denjtë i NATO-s, është një prioritet i qeverisë shqiptare dhe politikave të ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë sfidë të vërtetë, një rol po luajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo, jo vetëm në rritjen profesionalisht të kapaciteteve njerëzore, por edhe në nivelin teknik.

"Krah për krah me aleatin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Në Policinë Ushtarake, falë mbështetjes së Ambasadës së SHBA në Tiranë, janë ndërtuar mjediset e reja të ndalimit disiplinor. Bashkëpunimi do të vijojë me trajnimin e specialistëve të hetimit në Forcat e Armatosura", ka postuar mesazhin e saj ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në facebook.

Kurse ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim, në intervistën e datës 10 korrik, publikuar në shtypin shqiptar, shprehej se: "Mund të them se jemi krenarë të jemi aleatë në NATO me Shqipërinë. Mendoj që për ne, është shumë e rëndësishme. Secili aleat me të cilin jemi krah për krah në NATO, është i rëndësishëm. Për Shqipërinë, Shtetet e Bashkuara kanë investuar shumë e shumë miliona dollarë, tek marrëdhënia dhe tek përpjekja për të përmirësuar kapacitetet e Shqipërisë si aleate. Mendojmë se janë para të shpenzuara mirë. Kur shohim kontributet e ushtrisë shqiptare, të forcave shqiptare, madje duke përfshirë edhe sakrificën e jetës hera-herës, jemi krenarë të jemi aleatët tuaj. Mendoj se deri tani, kemi ofruar mbi 180 milionë dollarë në asistencë për mbrojtjen, vetëm në pak vitet e fundit" - u shpreh ambasadorja.

Kollçaku-Rama: Të intensifikohet plani i bashkëpunimit ushtarak midis FARSH-së dhe FSK-së

Me ftësë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama zhvilloi më 23 korrik 2020, një vizitë zyrtare në Tiranë. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis FSK dhe FARSH.

Agjendën e tij, gjeneral Rama me delegacionin shoqërues e filloi me vizitën në Ministrinë e Mbrojtjes, ku me ceremoni dhe nderimet më të larta ushtarake u prit nga homologu i tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku shoqëruar nga stafi i tij më i lartë. Në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral Rama, takimin e parë e zhvilloi me zëvendësministrin e Mbrojtjes, Petro Koçi dhe stafin e tij. Në fillim, zëvendësministri Koçi e njoftoi gjeneral Ramën me zhvillimet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, vlerësimin e lartë të nivelit të bashkëpunimit ndërministror dhe ndërushtarak me zotimin për thellim dhe zgjerim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Duke shprehur falënderimin për ftësën dhe pritjen vëllazërore, gjeneral Rama vlerësoi lart mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe instancat tjera shtetërore për mbështetjen e deritashme në të gjitha aspektet me theks të veçantë në aspektin e diplomacisë ushtarake, ku si vend anëtare e NATO-s, Kartës së Adriatikut (A5) dhe iniciativave rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes, ka ndikuar shumë në fuqizimin e pozicionit të ministrisë sonë dhe FSK-së në strukturat përkatëse.

Pastaj, gjeneral Rama, pas pritjes me ceremoni nderi, zhvilloi takimin me homologun e tij me gjen-

Ne kemi shumë mundësi për të ngritur, zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin tonë ushtarak në nivele akoma më të larta, duke rritur implementimin e planeve të dakordësuara



eral Kollçakun. Në fillim të takimit, të dy gjeneralët informuan njëri-tjetrin lidhur me zhvillimet e përgjithshme aktuale të forcave, sfidave aktuale të shkaktuara nga kriza e pandemisë COVID-19 si dhe objektivat zhvillimor për të ardhmen. Pastaj fokusi i takimit në mes të dy delegacioneve respektive ishte në çështjet kryesore me interes të përbashkët, respektivisht vlerësimin e shkallës së realizimit të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh FSK-FARSH, aktivitetet në proces të realizimit si dhe ato të planifikuara për të ardhmen. Gjeneral Rama shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për mbështetjen e deritashme në të gjitha fushat të FARSH për FSK-në duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e ofritit të mbështetjes së ndërsjellë nga ana e FSK-së në fushat që vlerësohen nga ana e FARSH -së. Nga ana e tij, gjeneral Kollçaku, çmoi lart të arriturat e deritashme të FSK-së me theks të veçantë në aspektin e profesionalizimit të burimeve njerëzore dhe shkallës së operacionalitetit të gjitha këto të dëshmuara me sukseset e larta në të gjitha nivelet arsimore-stërvitore të përbashkëta në kuadër të akademive dhe stërvitjeve shumëkombëshe, si dhe në operacionet e realizuara.

“Dua të shpreh një falenderim të veçantë për kontributin dhe ndihmën e pakursyer të burrave dhe grave të FSK gjatë tërmetit të nëntorit të vitit të kaluar, si dhe mbështetjen e pamatë dhe shumë bujare për arsimimin e ushtarakëve tanë në Kosovë. Pavarësisht nivelit të shkëlqyer të bashkëpunimit ushtarak, unë besoj dhe jam i sigurt, ashtu sikurse u shprehët edhe ju, që ne kemi shumë mundësi për të ngritur, zgjeruar dhe thelluar këtë bashkëpunim në nivele akoma më të larta, duke rritur ritmin e implementimit të planeve konkrete të dakordësuara”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku gjatë takimit.

Në fund të dy u dakorduan për intensifikimin e bashkëpunimit në nivel të mbështetjes së ndërsjellë dhe në nivel të shkëmbimeve të eksperiencave, aftësive dhe kapaciteteve në fushat me interes të përbashkët.

Gjatë takimit gjeneral Kollçaku

Presidenti Meta pret gjenerallejtnant Rrahman Rama

Gjatë vizitës zyrtare në Tiranë, gjenerallejtnant Rrahman Rama është prituri në një takim të veçantë, nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, shkëlqesia e tij Ilir Meta i cili shprehu edhe njëherë admirimin e madh për FSK-në dhe besimin e plotë për perspektivën zhvillimore të saj të afërt në strukturat operacionale të NATO-s në misionet paqeruajtëse duke fuqizuar rolin e Kosovës në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë.

Gjeneral Rama i ritheksoi mirënjohjen dhe falënderimin Presidentit Meta për mbështetjen e tij të pandërprerë në të gjitha etapat e zhvillimit të forcave ushtarake të vendit nga të gjitha pozitat e tij të lidhshme shtetërore dhe besimin e plotë në rolin dhe angazhimin e njëjtë për FSK-në edhe në të ardhmen. Për këtë arsye edhe simbolikisht i dhuroi uniformën kamuflazh të FSK-së.



shoqërohej nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5/8), kolonel Bilbil Bitri, drejtor i kabinetit të tij, Kolonel Arben Zani, oficeri i J5/8, nënkolonel Fredi Maksuti dhe këshilltari i tij politik, Perikli Koliqi. Gjatë vizitës dhe takimeve gjeneral Rama u shoqërua nga del-

egacioni i përbërë prej atasheut të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, kolonel Bashkim Shillova, këshilltarit ushtarak, nënkolonel Berat Shala, zyrtarit për politika dhe marrëdhënie ndër-institucionale, Ali Bajqinovci si dhe asistentes ushtarake, kapiten Manushaqe Nura.

“Kalorës i Urdhrit të Flamurit”, për atasheun ushtarak italian, Kolonel Cornacchia

“Vlerësim për kontribut të çmuar në forcimin e urave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të ushtarakëve shqiptarë sipas standardeve euroatlantike”

Presidenti Ilir Meta dekoroi Atasheun ushtarak italian, Kolonelin Fabio Cornacchia me titullin e lartë “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”, me motivacion vlerësimin e kontributit të çmuar për forcimin e urave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të ushtarakëve shqiptarë, sipas standardeve euroatlantike. Me mirënjohje për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe popujve miq.

Në ceremoninë solemne të zhvilluar ditën e dielë, më 5 korrik 2020, ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ambasadori i Republikës së Italisë në Tiranë, Fabrizio Bucci, përfaqësues institucionesh dhe autoritete vendore, familjarë, miq dhe kolegë të atasheut ushtarak.

Në fjalën e tij, Presidenti Meta vuri në dukje kënaqësinë e veçantë të organizimit të një ceremonie solemne për të nderuar Kolonelin Cornacchia, ushtarak i një vendi partner strategjik të gjithanshëm, Italisë.

“Kolonel Cornacchia ka një përvojë të shkëlqyer, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera me forcat e NATO-s. Misioni i parë i tij në vendin tonë ka qenë në vitin 1999, gjatë Luftës së Kosovës, ku kontribuoi si pjesë e operacionit të forcave të NATO-s, për të përballuar krizën e refugjatëve në atë situatë të vështirë dhe historike. Ajo eksperiencë la gjurmë të forta në kujtesën e tij ndaj edhe kur iu ofrua mundësia të kthehej në Shqipëri rreth dy dekada më vonë si Atashe Ushtarak i Italisë gjë që e priti me shumë kënaqësi”, -u shpreh Meta.

Ai tha se gjatë këtyre viteve si Atashe Ushtarak në vendin tonë ai ka dhënë një kontribut të shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin shumë të mirë midis forcave ushtarake italiane dhe atyre shqiptare në të gjitha drejtimet.

“Sidomos lidhur me edukimin dhe formimin e ushtarakëve tanë në shkollat ushtarake italiane, stërvitjet dhe përgatitjet për operacione të përbashkëta të policisë ushtarake dhe karabinierisë, së fundmi edhe në



fushën e shëndetësisë ushtarake. Në veçanti falenderojmë Kolonelin Cornacchia për angazhimin e tij në kohën e vështirë të pandemisë, për të lehtësuar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve shqiptarë për ndjekjen e studimeve në fushën ushtarake në Itali. Profesionalizmi, korrektësia dhe komunikimi i tij i shkëlqyer me kolegët shqiptarë, por edhe të vendeve partnere, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me të gjitha institucionet shqiptare e kanë bërë Kolonelin Cornacchia një

bashkëpunëtor mjaft të çmuar të Forcave të Armatosura të vendit tonë”, -nënvizoi Presidenti.

Ai shton se, “Pas 3 vitesh shërbimi si atashe ushtarak, Kolonelin Cornacchia do të largohet nga Shqipëria për t’u kthyer në Itali. Por jam i sigurt se të dyja përvojat e tij në vendin tonë e kanë bërë një mik të pandashëm të Shqipërisë dhe jam i sigurt se gjithmonë do të jetë një mbështetës i marrëdhënieve tona, por edhe një promovues i të gjitha bukurive të Shqipërisë”.

Gjenerallejtënant Eric P. Wendt në Tiranë

Gjeneral brigade Kollçaku pret komandantin e Forcave Speciale të NATO-s

Më datë 20 korrik 2020 zhvilloi një vizitë në Forcat tona të Armatosura komandanti i Forcave Speciale të NATO, gjenerallejtënant Eric P. Wendt. Gjenerali Wendt u prit dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Në takim u diskutua për situatën e sigurisë në rajon e më gjerë në zonat e përgjegjësisë dhe interesit të Aleancës dhe nevojat për bashkëpunim në përgatitjen e zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të forcave speciale.

Forcat Speciale të NATO-s (SOF) ofrojnë shërbime për Forcat Ajrore, Detare dhe Tokësore të NATO-s dhe janë të rëndësishme në të gjithë gamën e plotë të operacioneve ushtarake. Këto aftësi të SOF janë gjithashtu të zbatueshme për detyrat thelbësore të Aleancës për mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Selia e Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ) është pika kryesore e zhvillimit, koordinimit dhe drejtimit për të gjitha aktivitetet e Operacioneve Speciale të NATO-s.



Shefi i Zyrës së ODC, përfundon mandatin

“Certifikatë Mirënjohje” për nënkolonel Joshua Glendening

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, me rastin e përfundimit të mandatit në vendin tonë, i ka akorduar shefit të Zyrës së ODC, nënkolonel Joshua Glendening, “Certifikatë Mirënjohje”, për kontributin e vyer në bashkëpunimin dhe koordinimin në fushën e Mbrojtjes.

Në ceremoninë e organizuar në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes ishin të pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, Florian Kali, drejtoresha e Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes Belioza Çoku, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, komandanti i KDS, gjeneral major Bajram Bega, drejtorë drejtorish

në MM dhe SHP, atashu ushtarak amerikan në vendin tonë, kolonel James Hilton si dhe përfaqësues të zyrës së ODC në Ministrinë e Mbrojtjes. Në përshëndetjen e tij, gjeneral brigade Kollçaku pasi falënderoi nënkolonel Glendening për kontributin e tij në drejtim të bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis vendit tonë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, theksoi ndër të tjera: “SHBA kanë dhënë një kontribut të veçantë në drejtim të modernizimit të Forcave të Armatosura, duke mbështetur me projekte si: mjetet taktike të blinduara, helikopterët Black Hawk, Bazën Ajrore të Kuçovës, njësinë e Mbrojtjes Kibernetike si dhe mjetet taktike të komunikimit.”, - u shpreh gjeneral brigade Kollçaku.

Kush është Gjenerallejtënant Eric P. Wendt?

Gjenerallejtënant Eric P. Wendt është një ushtarak amerikan karriere. Ai ka një diplomë “Bachelor” nga Universiteti i Kalifornisë në Santa Barbara në “Drejtësi dhe Shoqëri” dhe një Master për “Çështje të Sigurisë Kombëtare” nga Shkolla Pasuniversitare Detare në Monterey, California.

Eric P. Wendt ka një karrierë të gjatë ushtarake. Ai ka shërbyer si një oficer aktiv i ushtrisë amerikane që nga viti 1986. Ai shërbeu gati pesë vjet në këmbësori, dhe më pas ka shërbyer si një Green Beret, oficer i forcave speciale.

Wendt ka shërbyer në disa vende të botës, si në: Indonezi si Shef Ekipi për Komandantin e Komandës së SHBA-ve në Paqësor, në Ekipin e Vlerësimit të Situatës së Paqësorit (PSAT), në operacionin Liria e Qëndrueshme-Filipine (OEF-P) në Mindanao në jug të Filipineve, në Operacionin Liria e Irakut (OIF) dhe në Operacionin Liria e Përhershme-Afganistan (OEF-A).

Përveç pozicioneve të shumta, duke përfshirë shërbimin si Ndihmësi Kryesor Ushtarak i Sekretarit të Mbrojtjes, ai ka komanduar në çdo nivel të Forcave Speciale nga A-Team (ODA) deri në Komandën e Operacioneve Speciale të Teatrit Nën-Unifikuar (TSOC).

Gjenerallejtënant Eric P. Wendt flet anglisht, arabisht dhe gjuhën koreane. Atij i është akorduar “Kryqi i Artë Gjerman i Nderit” për shërbimin luftarak në Afganistan, medalja “Cheon Su” nga Presidenti i Republikës së Koresë, etj. Gjenerallejtënant Eric P. Wendt ka qënë edhe Koordinator i Sigurisë së Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Autoritetit Palestinez. Gjenerallejtënant Eric P. Wendt mori komandën e Forcave Speciale të NATO-s, në 7 Nëntor 2019.

Gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta Gjeneralmajor Bajram Begaj, merr detyrën si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Ministrja
Xhaçka:
“Gjeneralmajor
Bajram Begaj
është pady-
shim një nga
ushtarakët më
të përgatitur e
më me vlerë që
kanë sot FA”.

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, dekretuar me 29 korrik nga Presidenti Ilir Meta, njëkohsisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, më 30 korrik 2020 mori detyrën në një ceremoni ushtarake, ku flamurin kombëtar ia dorëzoi ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Më herët gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta dhe me dorën mbi Kushtetutë.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka falënderoi shefin në largim të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, për të cilin tha se do të vijojë të jetë pjesë e FA dhe për të dhënë kontributin e tij.

Ministrja Xhaçka e cilësoi gjeneralmajor Bajram Begajn si një nga ushtarakët më të kualifikuar, mëse i përshtatshëm për sfidat që po kalojnë jo vetëm Forcat e Armatosura, por edhe shoqëria në tërësi.

“Gjeneralmajor Bajram Begaj është

padyshim një nga ushtarakët më të përgatitur e më me vlerë që kanë sot FA. Unë pres, të gjithë ne presim, që drejtuesi i ri i Shtabit të çojë përpara procesin e modernizimit e profesionalizimit që tashmë ka fituar një momentum vërtet pozitiv. FA është sot një forcë që kontribuon me kontingjentet e saj krah për krah aleatëve në misione të vështira e të rrezikshme, ku efektivet tanë kanë marrë vlerësimet më të larta. FA është sot një forcë që po përthith me ritme mbresëlënëse jo vetëm pajisje e sisteme armatimi shumë herë më të avancuara sesa ato që kemi pasur në dispozicion deri pak vite më parë, por që po investon si kurrë më parë tek buri-
met e saj njerëzore. Gjeneralmajor Begaj zotëron kualifikime krejt të posaçme që e bëjnë atë një kandidat të shkëlqyer për kohën që kalojmë. Ai është jo vetëm një ushtarak karriere, me një karrierë jashtëzakonisht të pasur ku ka spikatur me përgatitjen, talentin dhe idetë e tij. Por ai është dhe një mjek, një nga mjekët më të njohur në fakt në Shqipëri. Pra,



ai është një ushtarak i trajnuar e kualifikuar për të kuptuar jo vetëm sfidat tradicionale të sigurisë, por edhe sfidat e jashtëzakonshme që na vijnë nga armiq të padukshëm por ndoshta akoma më të rrezikshëm.” - u shpreh zonja ministre.

Në fjalën e tij, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj tha se ishte mirënjohës për besimin e Presidentit Meta, Kryeministrit Rama dhe ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

“Akademia e Forcave tona të Armatosura është një histori suksesi që tregon se pavarësisht vështirësive dhe problematikave që mund të hasen nëse ka vullnet dëshirë dhe profesionalizëm rezultatet mund të arrihen. Transformimi i Akademisë Ushtarake dhe akreditimi institucional si i vetmi institucion i lartë i arsimit publik për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare do sjellë ndryshim rrënjësor në rrjedhën e arsimit profesional ushtarak dhe përgatitjen cilësore të ushtarakëve. Misioni i FA është ruajtja e paqes dhe sigurisë që tashmë e realizojmë si anëtarë të NATO-s, ku vendi ynë dhe Forcat e Armatosura po dëshmojnë se dinë të solidarë me aleancën, të mbajnë barrën e detyrimeve që u takon por dhe të kontribuojnë në sigurinë kolektive për paqen globale dhe rajonale”, u shpreh ai.

Gjeneral brigade Bardhyl Kolçaku, i cili dorëzoi detyrën falënderoi bashkëpunëtorët e dhe përmendi arritjet e Forcave të Armatosura gjatë drejtimit të tij, pa harruar të përmendë çastet e vështira, që nga përmbytjet, te tërmetet dhe së fundmi gjatë pandemisë.

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj shërbente si komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, gjatë drejtimit të së cilës e shndërroi Akademinë e FA në një institucion të mirëfilltë të arsimit të lartë dhe në të vetmin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka lindur në vitin 1967 në Rrogozhinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin ‘Mjekësi’ në vitin 1998.

Gjeneralmajor Begaj betohet para presidentit të Republikës Ilir Meta

“Betohem se do t’i bindem Kushtetutës e ligjeve, do t’i shërbej me ndershmëri vendit tim dhe do të mbroj interesat e Republikës së Shqipërisë”

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Rushit Begaj u betua më 30 korrik 2020, para Presidentit të Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, njëkohësisht Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pas ekzekutimit të himnit kombëtar dhe leximit të dekretit të emërimit, Gjeneral Major Begaj duke vënë dorën mbi Kushtetutë, u zotua para Presidentit Meta se:

“Betohem se do t’i bindem Kushtetutës e ligjeve, do t’i shërbej me nder-



shmëri vendit tim dhe do të mbroj interesat e Republikës së Shqipërisë.”

Duke i dorëzuar dekretin e emërimit, Kryetari i Shtetit i uroi Shefit të Shtabit të Përgjithshëm punë të mbarë dhe suksese në detyrën tepër të rëndësishme në drejtimin e Forcave të Armatosura shqiptare. Presidenti Meta theksoi se edukimi dhe specializimi i Gjeneral Major Begaj në fushën e mjekësisë është një vlerë e shtuar që do ta ndihmojë atë në ushtrimin me përgjegjshmëri të lartë të kësaj detyre, veçanërisht në kushtet e përballimit të sfidave të kohës për Forcat tona të Armatosura, si pjesë e NATO.

Në ceremoninë e betimit ishin të pranishëm edhe ministrija e Mbrojtjes zonja Olta Xhaçka, Zëvendës shefja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, Komandanti i Forcës Tokësore Gjeneral Brigade Albert Mullai, si dhe Komandanti i Komandës Mbështetëse të FA-ve, Gjeneral Brigade Ndrçim Sallaku.

Presidenti i Republikës, z.Illir Meta, dekreton:

Gjeneral major Bajram Bega, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z.Illir Meta, me dekret Nr.11527, datë 29 korrik 2020 ka dekretuar sot emërimin e gjeneralmajor Bajram Begës, shef të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH. Dekreti, si më poshtë vijon: "Në mbështetje të nenit 93 dhe pikës 3, të nenit 169, të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin nr. prot.. 3830/1, datë 29.07.2020 të kryeministrit, Dekretoj: Gjeneralmajor Bajram Rushit Begaj, me detyrë komandant Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjeneral Major Bajram Begaj, ka lindur në datë 20.03.1967, në Rrogozhinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998. Ai gjithashtu ka përfunduar

"Doktoraturën në Fushën e Mjekësisë", ndërsa mban edhe titullin "Profesor i Asociuar" në Mjekësi. Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer: "Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen", në Shqipëri; "Shkollën e thelluar pasuniversitare të mjekësisë", në Shqipëri; "Specializimin Pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji", në Shqipëri; "Kursin e menaxhimit spitalor" dhe "Kursin e lidërshimit mjekësor strategjik", në SHBA; "Specializimin në fushën e mjekësisë" dhe "Kursin e Shëndetësisë", në Greqi. Ai ka kryer detyra të ndryshme si: Shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendës drejtor Ushtarak i SUT,

Drejtor i Spitalit Ushtarak, etj. Aktualisht, ishte në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHSHPFA) është detyra më e lartë ushtarake në FA. Mandati i tij është 3-vjeçar dhe emërohet me dekret të presidentit të Republikës, me propozim të kryeministrit. Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA në vitin 2017. Gjeneralmajor Bajram Begaj i dekretuar si shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të FA, mbante detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dekreton

Gjeneral brigade Bajram Begaj merr gradën madhore "Gjeneral Major"

Presidenti i Republikës SHTZ. Ilir Meta, dekretoi me nr. 11535 datë 3.7.2020 dhënien e gradës madhore "Gjeneral Major" për Gjeneral Brigade Bajram Rushit Begaj, me detyrë "Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes".

Gjeneral Major Bajram Begaj, ka lindur në datë 20.03.1967, në Rrogozhinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998. Gjeneral major Begaj, ka përfunduar "Doktoraturën në Fushën e Mjekësisë", në Shqipëri si dhe mban titullin Profesor i asociuar në Mjekësi. Gjatë karrierës 31 vjeçare ushtarake ka kryer, Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen; Shkollën e thelluar pasuniversitare të mjekësisë, specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidërshimit mjekësor strategjik, në Shtetet e Bashkuara të



Amerikës si dhe kursin epecializimit në fushën e mjekësisë dhe kursin e shëndetësisë, në Greqi.

Aktualisht Gjeneral Major Begaj mban postin e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura, ndërkohë që në 31 vitet e karrierës në FA ka mbajtur një

sërë detyrash mes të cilave: shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendës drejtor Ushtarak i SUT, drejtor i Spitalit Ushtarak, drejtor i Inspektoratit Shëndetësor dhe Kryeinspektor dhe Këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm Ushtarak Qendror Universitar etj.

Forcat Detare, Forcat Ajrore dhe Speciale stërviten në Pashaliman

Në Ditën e Vizitorëve të Shquar ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku

Baza Detare e Pashalimanit u shndërrua për rreth dy javë në teatrin më të madh stërvitor të Forcave të Armatosura për këtë vit. Efektivë nga katër kompanitë e Batalionit të Forcave Speciale, të mbështetur nga anijet e Forcës Detare dhe helikopterët e Forcës Ajrore, testuan dhe rritën me tej aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t'u përballur me situata të ndryshme që mund kërcënojnë sigurinë dhe paqen.

Gjatë stërvitjes dyjavore, trupat e Forcave Speciale improvizuan skenarë të ndryshëm, në tokë dhe në det. Ndërhynë nga toka duke goditur dhe kontrolluar mjete dhe të dyshuar për transport të lëndëve plasëse, testuan aftësitë e bordingut duke u infiltruar nga ajri dhe deti në një anije të dyshuar, goditën elementë kriminalë dhe terroristë me anë të zbarkimit nga deti si dhe rritën kapacitetet e zhytësve të Batalionit Special. Në Ditën e Vizitorëve të Shquar të kësaj stërvitjeje ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili shoqërohej nga komandantët e forcave kryesore.

Gjeneral brigade Kollçaku e vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin mes tre forcave duke i përgëzuar jo vetëm për aftësitë e treguara gjatë stërvitjes, por edhe për angazhimin e tyre gjatë periud-



hës së pandemisë. Më tej, shefi i Shtabit i siguroi trupat pjesëmarrës në stërvitje dhe gjithë ushtarakët shqiptarë për përmirësimin e kushteve të punës dhe stërvitjes, modernizimin e FA me armatim, mjete dhe pajisje, pa harruar trajtimin financiar të tyre.

Stërvitja e Forcave Speciale në Pashaliman, në bashkëpunim me Forcën Detare dhe atë Ajrore është e para e këtij niveli për të këtë vit në Forcat e Armatosura, të cilat kanë qenë të angazhuara në përballimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia.

Komanda Mbështetëse, Forca Detare dhe ajo Tokësore

Më shumë siguri për turistët vendas apo të huaj të cilët frekuentojnë në ditë e verës ishullin e Sazanit. Komanda Mbështetëse e Forcave të Armatosura, në bashkëpunim me Forcën Detare dhe atë Tokësore ndërморën më 9 korrik 2020, operacionin e pastrimit të ishullit të Sazanit nga municionet luftarake, të depozituara ndër vite në këtë ishull.

Gjatë operacionit të forcave xheniere janë shpërthyer konform protokollit të sigurisë municione të paplasura të llojit predha artilerie, te

Pastrohet Sazani nga municionet e rrezikshme luftarake

Janë shpërthyer konform protokollit të sigurisë municione të paplasura të llojit predha artilerie, të kalibrave: 120 mm, 130 mm dhe 77 mm

kalibrave: 120 mm, 130 mm dhe 77 mm. Operacioni, i kryer nën masa të rrepta sigurie bëri të mundur pastrimin nga municionet, që ishin grumbulluar prej vitesh në ishullin e Sazanit, i cili vitet e fundit frekuentohet nga turistë vendas e të huaj në periudhën maj – shtator.

Operacioni në Sazan nuk është i fundit nga ana e Forcave të Armatosura, pasi kontrolli dhe monitorimi i gjendjes së sigurisë në këtë ishull do të jetë i vazhdueshëm deri në pastrimin e plotë të zonës, që për vite me rradhë ka shërbyer si bazë ushtarake.

Zhvillohet demonstrimi stërvitor “Pashalimani 2020”

Në Garnizonin e Flotiljes Detare Pashaliman dhe konkretisht në Gjirin e Dukatit u zhvillua demonstrimi stërvitor “Pashalimani-2020”, si pjesë e përmbylljes së stërvitjes së përbashkët 10-ditore me të njëjtin emër të Forcave Speciale në bashkëpunim me Forcën Detare dhe atë Ajrore.

Efektivë të Batalionit të Forcave Speciale, të mbështetur nga anijet e Forcës Detare P-134 “BUTRINTI” dhe P132 “ORIKU” si dhe helikopteri “COUGAR” i Forcës Ajrore, testuan dhe rritën me tej aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t’u përballur me situata të ndryshme, që mund kërcënojnë sigurinë dhe paqen. Për këtë qëllim në datat 7 dhe 8 korrik 2020 u zhvilluan demonstrime stërvitore me skenarët, ndërhyrje nga toka duke goditur dhe kontrolluar mjete të dyshuar për transport të lëndëve plasëse, testimi i aftësive të bordingut duke u infiltruar nga ajri dhe deti në një anije të dyshuar, goditjen e elementëve kriminalë dhe terroristë me anë të zbarkimit nga deti si dhe rritën kapacitetet e zhytësve të Batalionit Special.

Në këtë demonstrim ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, zëvendëskomandanti Forcës Detare, kapiten i rangut I Artur Meçollari, zëvendëskomandant i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka, zëvendëskomandanti i Flotiljes Detare Pashaliman Kapiten i Rangut të dytë Dritan Seraj si dhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjeve, në SHP, kolonel Leonard Çoku.

Kjo stërvitje, duke qenë e përvojshme, sivjet erdhi me eksperiencë dhe elementë të shtuar me një objektiv domethënës, sikurse ishte bashkërendimi i veprimeve të tre llojeve të forcave për integrimin e kapaciteteve të tyre në tokë, det dhe ajër, në interes të përmbushjes së misioneve specifike që kryejnë sot forcat



Stërvitje e përbashkët 10-ditore midis Forcave Speciale, Forcës Detare dhe Forcës Ajrore

speciale në një ambient sigurie me kërcënime dhe rreziqe të paparashikuara hibride dhe asimetrike, pati si qëllim rritjen e aftësive operacionale të Forcave Speciale në kryerjen e operacioneve në hapësirën detare, të kombinuara njëkohësisht edhe me operacione tokësore dhe ajrore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, në përshëndetjen e tij drejtuar trupave pjesëmarrëse në këtë stërvitje, vlerësoi angazhimin e përkushtimin e tyre dhe të komandave përkatëse për realizimin e qëllimit dhe objektivave të stërvitjes. “Një përfundim është qartësisht i dukshëm: vullneti, komunikimi për bashkëpunim, koordinim dhe veprim si ekip i përbashkët, ajo që në gjuhën tonë ushtarake e quajmë forcë detyre e bashkuar, është çelësi i suksesit! Dhe kjo duhet të na karakterizoj jo vetëm në stërvitje.”, - u shpreh ndër të tjera gjenerali brigades

Kollçaku. Baza Detare e Pashalimanit u shndërrua për rreth 2 javë në teatrin më të madh stërvitor të Forcave të Armatosura për këtë vit.

“Efektivë nga 4 kompanitë e batalionit të Forcave Speciale, të mbështetur nga anijet e Forcës Detare dhe helikopterët e Forcës Ajrore, testuan dhe rritën me tej aftësitë dhe kapacitetet e tyre, për t’u përballur me situata të ndryshme që mund kërcënojnë sigurinë dhe paqen”, - shkruan ministria Xhaçka ne facebook.

Dinamika e demonstrimit të ndjekur nga të pranishmit përmbante: ndërhyrjen e Forcave Speciale kundër grupeve terroriste të dyshuara për trafik ndërkombëtar të lëndëve plasëse, bording në anije (infiltrim nga deti dhe ajri), kontroll i anijes së dyshuar për transportin e lëndëve plasëse dhe goditje direkte të elementëve terroristë me anë të zbarkimit nga deti, SSE (Sensitive Site Exploitation).

Helikopteri “COUGAR” mbështeti stërvitjen “Pashalimani 2020”

Forca Ajrore, me një helikopter COUGAR ka mbështetur stërvitjen e përbashkët dhjetë ditore “Pashalimani 2020” i cili u zhvillua në Garnizonin e Flotiljes Detare Pashaliman dhe konkretisht në Gjirin e Dukatit. Në këtë stërvitje, nga ekuipazhi i helikopterit “COUGAR”, u kryen veprime të shpejta dhe të sakta duke koordinuar me trupat special të Batalionit të Forcave Speciale dhe anijes së Forcës Detare. Kjo stërvitje ishte një hap i rëndësishëm, pasi ishte stërvitja e parë e përbashkët për vitin 2020 dhe u zhvillua pas një kohe të gjatë ndërprerje si pasojë e COVID-19. Realizimi me sukses i stërvitjes së përbashkët “Pashalimani 2020”, si nga pjesëmarrësit e forcave të tjera dhe të ekuipazhit fluturues të Forcës Ajrore, u përshëndet edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Një ish-anije ushtarake është mbytur në Dhërmi më 28 korrik 2020, për t'u shndërruar në një atraksion turistik për të apasionuarit e botës nënujore. "Një destinacion i ri për zhytje.

Kjo ish anije ushtarake, tashmë do të shërbejë si një atraksion turistik nënujor",- shkruan kryeministri Rama ne facebook. Në aktivitetin promovues të pranishëm ishin dhe ministri i Turizmit, Blendi Klosi, zëvendësministri i mbrojtjes Petro Koci, prefekti i Vlorës dhe përfaqësues të komandës ushtarake të Vlorës. Anija që u fundoset në Drimadhes ishte anije ushtarake e Marinës Shqiptare e vitit 1974. Kjo anije nuk përdorej prej 30 vitesh. Anija që u fundos në Drimadhes, në Dhërmi ka ardhur në Shqipëri nga Kina në vitin 1974 dhe ka qenë pjesë e marinës së Vlorës. Anija është zhytur rreth 200 m larg bregut në Drimadhes dhe do të mund të vizitohet nga të pasionuarit pas sportit të zhytjes. Në projekt janë parashikuar të zhyten edhe anije të tjera ushtarake, që kanë dalë jashtë funksionit. Emri i anijes që u mbyt është 'Polubarja Kineze'.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, ka publikuar një video me pamje nga mbytja e ish-anijes ushtarake. "Në kushtet e reja, domosdoshmëria është që me hapjen e turizmit detar shqiptar, të zgjerohet format dhe tematikat e ofertës turistike, me qëllimin e një turizmi dinamik dhe konkurrues në rajon. Vetëm pak ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit për aktivitetet detare, ligji i cili mundëson shfrytëzimin e hapësirës jo vetëm për peshkim, por edhe për turizëm elitare dhe aktivitete ujore, krijojmë sot një destinacion të ri për të gjithë turistët dhe të apasionuarit e detit që duan të eksplorojnë fundin e detit dhe atraksionet nënujore", -theksoi Klosi.

Gjithashtu, shtoi Klosi: "ky destinacion nënujor do të jetë atraksion në zonën e Drimadhes dhe pjesë e hartës së aktiviteteve të turizmit detar, e cila miratohet në KKT". "Këto harta parashohin vendet e lejuara dhe vendet e ndaluara të ushtrimit të aktivitetit detar. Përbëhet nga 60 zona, ku secila prej tyre do të ketë pasaportën



"Mbytet" në Dhërmi anija ushtarake "Polubarja Kineze"

Një ish-anije ushtarake shndërrohet në një atraksion turistik



Ajo do të shërbejë si një atraksion turistik në ujërat e Drimadhesit në Dhërmi për të apasionuarit pas zhytjes.

e detajuar për Zonat e Lundrimit, zhytjes, peshkimit nënujor, destinacionet nënujore apo aktiviteteve të tjera ujore. Miratimi i këtyre hartave, "celebrohet" me ndërtimin e destinacioneve nënujore të mjeteve lundruese të përdorura nga forcat detare të Ministrisë së Mbrojtjes, që kanë dalë tashmë nga përdorimi dhe do të zhyten në ujë për të krijuar një atraksion turistik",- shton Klosi.

Ai nënvizon se, "këto aktivitete do të jenë në përditësim të vijueshëm, duke patur pritshmërinë e një vlere të rritur ekonomike dhe ofertë e shtuar turistike për vendin. Në këto harta, planifikohen edhe zonat ku mund të vendosen stacionet sezonale të ankorimit dhe pontilet lundruese". "Miratimi i hartave të përgjithshme detare, i hap rrugë certifikimit të operatorëve të turizmit detar dhe prezantimit të ofer-

tës turistike detare të vendit tonë. Për pothuaj 3 dekada, turizmi detar nuk ka patur asnjë lloj zhvillimi, duke e lënë bregdetin shqiptar një hallkë të munguar të zinxhirit të zonës së zhvilluar të Mesdheut",- tha ai.

"Ligji i Turizmit Blu, synon nxitjen dhe ngritjen e porteve dhe marinave shqiptare. Ky ligj që ofron avantazhet më të larta në rajon, të regjistrimit të mjeteve të lundrimit për argëtim në vendin tonë. Përpos kësaj, mbajtja e flamurit shqiptar nga mjete detare që lundrojnë në të gjithë botën, ofron një marketim të Shqipërisë si destinacion turistik",- shoti Klosi. "Shndërrimi i bregdetit shqiptar, në destinacionin më të njohur dhe të zhvilluar të jahteve në rajon, është synimi dhe pritshmëria e ligjit për veprimtaritë detare, një aktivitet që sjell të ardhura të larta në industrinë turistike",- tha ai.

Projekt në fushën e mbrojtjes civile dhe administrimit të rrezikut

Projekti si financim i BE-së, me vlerë 5 milionë euro, pjesë e Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi përfundon në qershor 2022

Projekti "TO BE READY-The flood and Big fire forecast, prediction, forecast and emergency management", financohet në kuadër të thirrjes tematike të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Projekti me vlerë 5.009.633.49 Euro ka filluar në shtator 2019 dhe do të zgjasë deri në qershor 2022.

Projekti, i udhëhequr nga rajoni i Molises, përfshin partneritetin e autoriteteve kryesore kompetente në fushën e mbrojtjes civile dhe administrimit të rrezikut, të cilat kanë përvojë dhe ekspertizë në kërkimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. Ky partneritet do të jetë në gjendje të zhvillojë strategjitë më të mira në përmirësimin e kushteve me qëllim rritjen e parrezikshmërisë nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut të basenit italian, shqiptar dhe malazez, duke vënë në zbatim iniciativa ndërkuftare të afta të krijojnë një urë midis rajoneve pjesëmarrëse në mënyrë që të adoptohen strategji të koordinuara bashkërisht për ndërhyrje në raste zjarresh dhe përmytjesh.

Qasja ndërkuftare, përfaqëson një vlerë të shtuar për projektin dhe ka të bëjë me veçoritë e ndryshme të territoreve të përfshira dhe me mënyrat e ndryshme të parandalimit dhe ndërhyrjes në rast të zjarreve, ose përmytjeve, të cilat të integruara, sigurojnë që do të kontribuojnë në zhvillimin e një modeli operativ të suksesshëm. Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA II). Shoqëria partnere: Rajoni Molises-Leader.

Partnerët e projektit: Rajoni Molise-Departamenti i Mbrojtjes Civile; Rajoni Puglia- Departamenti i Mbrojtjes Civile; Ministria e Brendshme e Malit të Zi-Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave; Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë-Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Kurse Partnerët e asociuar janë Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë - Drejtorja e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri.

Aktivitetet e projektit bazohen në tre nga katër shtyllat themelore të sistemit të mbrojtjes civile: Parashikimi i emergjencës, parandalimi dhe menaxhimi.

Projekti synon të lëshojë një sfidë të përbashkët ndërmjet zonës së detit Adriatik të Italisë,



Shqipërisë dhe Malit të Zi, zona, që vitet e fundit, janë prekur nga fatkeqësi të ndryshme natyrore si edhe të shkaktuara nga dora e njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj rrezikut të zjarreve në pyje dhe atij të përmytjeve.

Partneriteti do të jetë në gjendje të zhvillojë strategjitë më të mira në përmirësimin e kushteve me qëllim rritjen e parrezikshmërisë nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut të basenit italian, shqiptar dhe malazez, duke vënë në zbatim iniciativa ndërkuftare të afta të krijojnë një urë midis rajoneve pjesëmarrëse në mënyrë që të adoptohen strategji të koordinuara bashkërisht për ndërhyrje në

raste zjarresh dhe përmytjesh.

Përmirësimi i koordinimit dhe nivelit të përgatitjes së aktorëve kryesorë strategjikë të përfshirë në fazën e parandalimit dhe menaxhimit të emergjencave në raste zjarri dhe përmytje. Promovimi i një modeli të përbashkët të parandalimit dhe ndërhyrjes që do të aktivizohet në vendet partnere. Modeli do të zhvillohet përmes aktiviteteve të afta për të stimuluar shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet tre vendeve partnere, krijimi i modeleve të ndërhyrjes dhe programeve trajnuese me sesione specifike mbi organizimin, protokollet dhe procedurat që aplikohen në vendet e pellgut të Adriatikut të Mesëm.

Qendra Stervatore Kuçovë

Përfundon Kursi Bazë i Avancuar i Nënoficerit

Në Qendrën Stervatore të Kuçovës u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka. Kolonel Zarka në fjalën tij përgëzoi drejtuesit e qendrës për përkushtimin dhe punën e bërë gjatë periudhës së COVID-19, për përgatitjen profesionale të kursantëve, ndërsa personelit të sapocertifikuar i uroi suksese dhe shtoi më tej se ky kurs do t'i shërbejë për marrjen e gradës së rradhës si tetar e rreshter dhe rritjen profesionale si teknikë të helikopterëve. Kjo ceremoni u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët dhe me një foto të përbashkët.

Prezenca e Përparuar e Përforcuar e NATO-s

Kontingjenti VII, EOD niset në misionin e NATO-s, në Letoni

21 efektivët e EOD, janë pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në dislokuara në Letoni.

Në mjediset e Batalionit të Xhenios (bXh) të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ditën e martë më 7 korrik 2020 ceremonia e nisjes së Kontingjentit VII, EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në dislokuara në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar edhe nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku.

Në përshëndetjen e tij drejtuar trupave, gjeneral brigade Kollçaku, duke e konsideruar nder dhe privilegj përcjelljen e 21 efektivëve të EOD, në misionin e NATO në Letoni, theksoi se përcjellja e këtij kontingjenti për në Letoni vjen pas një periudhe të vështirë pandemie, por që vuri në

sprovë dhe një herë gatishmërinë, profesionalizmin dhe disiplinën e hekurt të pjestarëve të Forcave të Armatosura.

"Këta djem dhe vajza do të vazhdojnë të kontribuojnë dhe ngrenë akoma më lart nderin, emrin dhe flamurin tonë duke ofruar kapacitetin EOD, i cili është konsideruar një kapacitet shumë i rëndësishëm mbështetës për grup-batalionin kanadez të dislokuar në Letoni"- u shpreh ai .Më tej gjatë përshëndetjes së tij, gjeneral brigade Kollçaku vuri theksin në rëndësinë që ka bxh në ndërtimin e urave, pastrimin e hotspotëve si dhe rindërtimin pas tërmetit të 26 Nëntorit të vitit të kaluar. Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin VII, EOD, që niset në Letoni dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Në misionin e FP të NATO në Letoni do të marrin pjesë 21 efektivë EOD, të cilët do të zëvendësojnë Kontingjentin VI, i cili pritet të kthehet këto ditë në atdhe.



Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi të Enjten e javës që kaloi, më 23 korrik 2020, marrëveshjen e bashkëpunimit financiar dhe ushtarak të nënshkruar me Turqinë, si dhe protokollin zbatues në lidhje me asistencën financiare mes dy vendeve. Drafti për ratifikimin e marrëveshjes u miratua me 105 vota pro, 4 kundër dhe 4 abstenime.

Gjatë fjalës së saj në seancë plenare, deputetja Elona Gjebrea tha se reforma e mbrojtjes dhe ristrukturimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, integrimi në NATO dhe transformimi i mbrojtjes janë çështje të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

“Që nga viti 1998, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar 26 marrëveshje ushtarake, grante dhe protokolle me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Turqia, ky partner strategjik i vendit tonë, e ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë dhe logjistikën ushtarake në përputhje me programin për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të vendit tonë”, - deklaroi Gjebrea.

Sa i përket marrëveshjes së lartpërmendur, Gjebrea u shpreh me këto fjalë: “Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, 2,3 milionë dollarë amerikanë do të përdoren për këto shërbime nga Ministria e Mbrojtjes. Është e domosdoshme që të merren të ardhura në të ardhmen që të thithen të gjitha fondet në përputhje me marrëveshjet dhe protokollat ushtarake të miratuara në vendin tonë. Projektligji që do të miratohet sot, është në përputhje me politikën e Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të anëtarësimit të vendit tonë në NATO. Falënderojmë palën turke që na është gjendur në situatë të vështira, përfshirë dhe faktin që vendi ynë u godit nga tërmeti muajt e kaluar. Shpresoj që kjo mbështetje të vijë në ndihmë jo vetëm për modernizimin e Forcave të Armatosura, por dhe për emergjencat civile”, - u shpreh deputetja përpara votimit për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë. Sipas Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, marrëveshja e bashkë-

2,3 milionë dollarë do të përdoren nga Ministria e Mbrojtjes

Projekti si financim i BE-së, me vlerë 5 milionë euro, pjesë e Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri -Mali i Zi përfundon në qershor 2022



punimit-nënshkruar mes palëve më 24.1.2020 dhe më 24.2.2020, ka për qëllim përcaktimin e parimeve në lidhje me dhënien e ndihmës financiare të alokuar, por të papërdorur,

me qëllim që të blihen shërbime për qëllime ushtarake mundësisht nga firmat dhe shoqëritë që e kanë 100 për qind të prodhimit të brendshëm kryesisht në Turqi.

Akademia e Nënoficerit

Zhvillohet stërvitja 24 orëshe “Çakalla 01-2020”

Kursi 65-të Fillestar i Nënoficerit në kuadër të programit mësimor, zhvilloi stërvitjen 24 orëshe kompaktësuese me temë “Çakalla 01-2020”.

Nëpërmjet kësaj stërvitje kursantët morën njohuri mbi elementët themelorë të personalitetit të n/tetarit si drejtues në rol të komandantit të grupit dhe detyra të njehsuara me të, edukimi, përgjegjësimi ndaj detyrës dhe gadishmërisë luftarake në zbatimin e urdhërave dhe disiplinës vetjake.

Stërvitja filloi me dhënien e urdhërit luftarak për marshim dhe kryerjen e marshimit në këmbë sipas itinerarit të përcaktuar me ide taktike. Kursantët u përballën me situata të ndryshme si veprimet e grupit në patrullë zbulimi, veprimet e grupit për ngritjen e pikës së kontrollit dhe ngritja e vendndalesës, veprimet e grupit në mbrojtje, si dhe veprimet e grupit në sulm.

Stërvitja u inspektua nga grupi i inspektimit i kryesuar nga Komandanti i ANO-së. Grupi i inspektimit vlerësoi stërvitjen 24-orëshe dhe mënyren e veprimit të kursantëve gjatë gjithë zhvillimit të stërvitjes, situatave të ndryshme, si dhe gjatë ngritjes të fushimit.



Pas periudhës 8-javore

Përfundon Kursi i 44-të i Avancuar i Nënoficerit në ANO

Forcat e Armatosura kanë nevojë gjithmonë për personel të motivuar, dedikuar, mirëtrajnuar e stërvitur

Procesi i trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit në ANO po konsolidohet dita ditës, në përputhje me standartet më të përparuara. Kësaj i shërben edhe kursi i 44-t i Avancuar i Nënoficerit i realizuar për një periudhë 8-javore.

Qëllimi i këtij kursi ishte ofrimi i njohurive teoriko-praktike për nënoficerët me gradën Tetar, për drejtimin në nivel toge dhe niveleve të njësuara me të.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, Komandanti i ANO-së, Kolonel Elton Bregu, i përshëndeti kursantët duke evidentuar rolin dhe rëndësinë e këtij kursi, si një tjetër gur kilometrik që i shtohet rrugës së gjatë të karrierës ushtarake për nënoficerët. "Forcat e Armatosura kanë nevojë gjithmonë për personel të motivuar, dedikuar, mirëtrajnuar e stërvitur. Për këtë fokusi kryesor duhet të jetë tek aftësimi i nënoficerëve për të drejtuar", - është shprehur kolonel Bregu.

Përfundimi i këtij kursi me sukses nga 33 kursantë, dëshmoi edhe

njëherë punën e bërë nga kursantët dhe instruktorët, duke evidentuar qartë faktin që ky kurs, e arriti qëllimin dhe pse në kushte të veshtira të temperaturave të larta dhe nën masa të rrepta mbrojtëse rigoroze ndaj pandemisë Covid-19.

Mbyllja me sukses e procesit mësimor të këtij kursi, u finalizua simbolikisht me mbjelljen e një peme në ambientet e jashtme të ANO-së. Një risi e përdorur së fundmi në të gjitha institucionet arsimore ushtarake të KDS, pjesë e së cilës është dhe ANO, janë dhe anketimet e bëra me kursantët në

përfundim të çdo kursi. Anketimi ka për qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies, si dhe rritjen e performancës dhe rezultateve pozitive të kursantëve. Pyetësori i anketimit është i ndarë në 3 module ku pyetjet konsistojnë në mendimin e kursantëve rreth: kursit në përgjithësi, materialeve mësimore, literaturës dhe vlerësimit, marrëdhënive me instruktorët, kolegët e tyre, metodave të mësimdhënies. Pyetjet janë me alternativa dhe të hapura me qëllim që të ketë saktësi dhe diversitet në përgjigje.

200 djem dhe vajza në luftë me zjarret

FA të angazhuara kundër zjarreve në pyje e kullota

Forcat e Armatosura janë angazhuar maksimalisht në përballimin e situatës së krijuar në vend nga zjarret në pyje e kullota, me qëllim garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare. Por kjo betejë, nuk është vetëm e Forcave të Armatosura", deklaroi ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

"Zjarret masive që kanë goditur pyjet e kullotat ditët e fundit kanë marrë përgjigjen tonë të menjëhershme. 200 djem e vajza të Forcës së Armatosur të angazhuar në Seman, Shkodër, Lezhë etj po japin maksimumin për të garantuar sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare", thekson Xhaçka.

"Dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë me çdo mundësi, çdo burim, aset e mjet që kemi. Por kjo nuk mund të jetë vetëm beteja e FA. Kjo



duhet të jetë beteja e të gjithëve ne, e çdo qytetari, e mbi të gjitha e çdo strukture të pushtetit vendor që ligji e ngarkon me përgjegjësi për të siguruar jetën dhe pronën e qytetarëve shqiptarë", nënvizon Xhaçka. Nga muaji janar deri në

korrik janë evidentuar 329 vatra zjarri, ku vetëm për muajin korrik janë evidentuar 168 vatra zjarri. Në total në të gjithë Shqipërinë janë djegur 598 hektarë, duke përfshirë dhe 2419 rrënjë ullishte dhe 217 rrënjë pemëtarie.

Kursi i 65-të Fillestar i Nënoficerëve, çertifikohen 51 kursantë

Më 8 korrik në mjediset stërvitore të ANO, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të 65-të Fillestar të Nënoficerëve. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti dhe zëvendëskomandanti i Akademisë së Nënoficerëve (ANO).

Kursi Fillestar i Nënoficerit, u zhvillua në ANO për një periudhë 5-javore dhe ka patur si qëllim hedhjen e bazave për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuara me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues grupi.

Programi mësimor i Kursit Fillestar të Nënoficerit ka qenë i fokusuar në marrjen e njohurive teorike dhe praktike për drejtimin e trupave në nivel grupi. Përvetësimi i njohurive të marra në lëndët: Lidërsip, Rregullore-Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri, Përgatitje Fizike, luajtën rol kryesor në formimin e tyre si komandantë të ardhshëm grupi.

Në pershëndetjen e tij në këtë ceremoni, komandanti i Akademisë së Nënoficerëve kolonel Elton Bregu, pasi falënderoi kursantët për disiplinën, durimin, sakrificat, nivelin e përkushtimit dhe përgjegjshmërinë e treguar gjatë zhvillimit të kursit, u shpreh ndër të tjera: "... jo gjithçka përfundon me këtë kurs, pasi arsimimi dhe trajnimi janë cikle



të vazhdueshëm dhe shpresojmë për një përdorim sa më të mirë në të ardhmen të njohurive e shprehive të marra në këtë kurs.

Në emër të kursantëve fjalën e mori nëntetar Ana Çelepija, e cila falënderoi trupën mësimdhënëse të ANO, "Do të doja të thoja se ky kurs ka qenë një ndërthurje shumë e mirë e mësimin, stërvitjes dhe përpjekjeve intensive për të arritur

këtu, duke u përballuar me të panjohura, sfida e rregulla, të shpalosura gjatë orëve teorike e praktike, por më dukshëm në stërvitjet fushore të zhvilluara. Ne sot jemi gati për të vazhduar më tej karrierën tonë ushtarake për të qënë pjesë e denjë e trupës së nënoficerëve". Ceremonia vijoi me shpërndarjen e certifikateve për kursantët dhe u certifikuan 51 kursantë.

Dhjetë vatra zjarri aktive, por nën monitorim

Rreth 200 efektivë të Forcave të Armatosura u kanë ardhur në ndihmë forcave zjarrfikëse në disa bashki të vendit, ku janë evidentuar disa vatra zjarri. 10 vatra zjarri ishin aktive, por nën monitorim dhe nuk paraqesin asnjë rrezik për qytetarët. Ndërkohë që 3 vatra janë shuar në qarkun e Dibrës.

Qendra Kombëtare Operacionale e Mbrojtjes Civile bën me dije se në Lezhë ishin aktive 4 vatra zjarri, në njësinë administrative Shëngjin, zona Rëra e hedhur-Maja e Zezë dhe po punohet për izolimin e tyre. Zjarri në malin e Kakarriqit është izoluar pothuajse totalisht.



Ndërsa në Rubik, në fshatin Kautund i Vjetër, vatra kishte intensitet të ulët dhe është nën monitorim. Në Elbasan ka patur një vatër zjarri në Gramsh në fshatin Siman. Policia ka nisur hetimin për shkaqet e zjarrit. Në Fier nga 3 vatra, 2 tashmë janë lokalizuar dhe janë drejt përmirësimit. Situata është nën kontroll edhe në fshatin Hekal, Mallkastër, ku u raportua për zjarr në sipërfaqe me shkurre ullishte dhe pemëtari. Vështirësi ka paraqitur terreni në njësinë administrative Terpan në pyllin e Ballollit në Berat, por zjarri nuk përbën rrezik për komunitetin, pasi ndodhet larg zonave të banuara.

FORCA AJRORE

Helikopteri “Coungar” me mision për shuarjen e zjarrit në Rubik

Në datën 29 korrik 2020, në dispozicion të Emergjencave Civile nga Baza Ajrore Farkë, u nis helikopteri Cougar për në pyjet e Molongut, në afërsi të fshatrave Katund i Vjetër-Rrasfik në zonën e Rubikut. Helikopteri Cougar i pajisur e kovën e posaçme për shuarjen e zjarrit ka përfunduar me sukses

operacionin e shuarjes së zjarrit duke hedhur rreth 40.000 litra ujë. Ky operacion ka zgjatur 2 orë e 50 minuta. Struktura e Forcës Ajrore dhe kryesisht Baza Ajrore Farkë do të vazhdojnë të qëndrojnë në gatishmëri për t'u përgjigjur në të gjitha rastet kur do kërkohet ndihma dhe ndërhyrja e tyre.



Certifikatë falenderimi për disiplinën dhe profesionalizmin e lartë

Ekupazhi i Forcës Ajrore në një operacion kërkim-shpëtimi

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ndau ditën e hënë më 6 korrik 2020, pamje nga një operacion real kërkim-shpëtimi i realizuar nga ekipazhet e Forcës sonë Ajrore. “Kjo nuk është një stërvitje! Shikoni se si duket një operacion real kërkim-shpëtimi nga ekipazhet e Forcës sonë Ajrore, e parë nga këndvështrimi i operatorit të bordit”, - tha Xhaçka. Ministrja shprehu krenarinë për pilotët dhe teknikët e FA-së që jo në shumicën e rasteve, por gjithmonë, iu duhet të operojnë në kushte dhe terrene jashtëzakonisht të vështira, në mal, në borë, në përmytje, në det,



Janë rindërtuar 170 shtëpi të shkatërruara nga tërmeti

170 banesa të dëmtuara nga tërmeti i 21 shtatorit janë rindërtuar nga themelet dhe po u dorëzohen banorëve. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka theksuar se ndihet e lumtur, teksa sheh rikthimin e buzëqeshjes së banorëve.

“170 shtëpitë e shkatërruara nga tërmeti i 21 shtatorit të vitit të kaluar në Krujë, Durrës, Kamëz, Rrogozhinë, Kavajë e Shijak janë rindërtuar nga themelet dhe po u dorëzohen banorëve. E lumtur tek shikoj që kemi rikthyer buzëqeshjen në fytyrat e tyre pas makthit të kaluar vetëm pak muaj më parë”, - shprehet Xhaçka.

“Shtëpia e re për qejf. Deri dje thoja inshallah s'bie shi. Kemi qenë në kavalishencën e Durrësit. Kam qëndruar gjashtë muaj atje”, - shprehet një qytetar. “Banesa jonë u dëmtua nga tërmeti 21 shtatorit. Falë ndërhyrjes së kësaj qeverie na bëri me një shtëpi të re nga e para. Vështirë se do ta kisha bërë nëse nuk do ndihmohesha. Kjo është bërë afërsisht për një muaj e gjysëm”, - tha një tjetër banor. “Do të jemi bashkë siç kemi qenë. Do jemi deri në fund të kësaj situatë pranë jush me ndihma”, - tha ministrja Xhaçka, teksa i dorëzonte çelësat e shtëpive të rindërtuara banorëve.

SHKOLLA E TRUPËS NË BUNAVI

Fillon periudha “blu” e stërvitjes Individuale Bazë

Stërvitja Individuale Bazë do vazhdojë 11 javë ku do të përgatitjen ushtarët profesionistë të FA

Rekrutët e rinj të Forcave të Armatosura përfunduan më 3 korrik 2020 periudhën “e gjelbër” të Stërvitjes Individuale Bazë në Shkollën e Trupës në Bunavi. Si asnjëherë më parë, i gjithë programi stërvitor po zhvillohet duke respektuar me përpikmëri masat kundër COVID-19.

Në këtë fazë të parë të stërvitjes, vajzat dhe djemtë janë njohur me rregullat dhe njohuritë fillestare për Forcat e Armatosura.

Me përfundimin e fazës së parë ka nisur edhe faza e dytë, ajo “blu”, e cila thellon njohuritë dhe përgatitjen e rekrutëve përpara se ata t'i nënshtrohen periudhës më të vështirë.

Periudha e fundit, e ashtuquajtur



“e kuqe”, do të jetë sprovë e vërtetë e rekrutëve të rinj, para se ata të titullohen e betohen si ushtarë të Forcave të Armatosura. Periudha “e kuqe”, kërkon nga rekrutët të tregojnë përgatitje të lartë fizike dhe sidomos psikologjike.

Stërvitja Individuale Bazë ka qëllim transformimin gradual të qytetarëve për rreth 11 javë nga civilë në ushtarë profesionistë të Forcave të Armatosura.



FORCA DETARE Çertifikohen tre oficerë të grupeve patrulluese të anijeve

Në anijen e klasit Iliria P-133 Lissus, u zhvillua ceremonia e dhënies së çertifikatave për vetëdrejtimin autonom të komandimit të anijeve klasi A-1. Ceremonia u zhvillua në gjirin e Durrësit, ku u çertifikuan tre oficerë të grupeve patrulluese të anijeve të Forcës Detare. Çertifikatat u dhanë nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut të parë, Artur Meçollari, i cili u uroi suksese të mëtejshme dhe erëra të mbara.

FORCA DETARE - PORTI I DURRËSIT

Në anijen “Iliria” zhvillohet testimi i vetëdrejtimit të anijes

Gjatë paraditës të datës 1 korrik 2020, në anijet e klasit “Iliria” në Portin e Durrësit u zhvillua testimi për vetëdrejtimin e anijes. Testimi u zhvillua në dy faza teorike dhe praktike. Në testim morën pjesë 8 oficerë!

Testimet u ndonjën nga Shefi i Shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut të dytë Sabri Gjinollari dhe Shefi i Degës Operacioneve dhe Stërvitjes kapiten i rangut të parë Engjell Sinanaj. Testimi praktik u zhvillua në det duke zbatuar disa skenarë ku u testuan aftësitë e Komandantëve dhe efektivave për drejtimin e sigurt të anijes.

Skenarët që u zhvilluan ishin dhënie ndihme njeriu në det, drejtimi i anijes në kushte të avarive të ndry-



shme në anije, lufta kundër zjarrit dhe ujit, mbrojtja e afërt e anijes etj.

Prioritet i Forcës Detare/ Rojes Bregdetare ishte zbatimi i misionit të saj si dhe detyrat kryesore ku një rëndësi të veçantë ka dhënia e ndihmës dhe shpëtimit në jetëve në det. Kjo merr edhe një rëndësi të veçantë gjatë sezonit turistik ku dhe fluksi i aktivitetit në det është në rritje.

Shkolla e Trupës në Bunavi

Bunavi, betohen 116 ushtarët e rinj të Forcave të Armatosura

Në mjediset e Shkollës së Trupës, Bunavi, pavarësisht kufizimeve të imponuara nga pandemia e "COVID-19", u zhvillua më 20 korrik 2020, ceremonia e betimit dhe çertifikimit të rekrutëve, të cilët përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u çertifikuan 116 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

"116 vajza dhe djem u betuan në Bunavi, si ushtarët më të rinj të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ripërtëritja e trupave është një cikël i zakonshëm në FA, por kësaj radhe dua t'i përgëzoj posaçërisht ushtarët e rinj, për vullnetin dhe sakrificën e jashtëzakonshme në këto kohë pandemie. Stërvitja në Shkollën e Trupës, nuk ishte aspak si herët e tjera dhe për këtë përgëzoj edhe instruktorët, të cilëve iu desh të përshtateshin me kufizimet e "COVID-19", shkruan ministria Xhaçka në facebook.

Betimi i ushtarëve të rinj erdhi pas përfundimit me sukses të Stërvitjes Individuale Bazë, e cila kësaj radhe u zhvillua në kushte jo të zakonshme, për shkak të pandemisë.

Rekrutët e rinj u testuan për COVID-19, në Tiranë, përpara nisjes së stërvitjes dhe gjatë qëndrimit në Shkollën e Trupës në Bunavi, iu nënshtruan kontrolleve periodike mjekësore.

Pjesët e programit stërvitor që zakonisht zhvillohen në klasa apo palestër, u improvizuan në mjedise të hapura, ndërkohë që edhe akomodimi i rekrutëve u bë duke respektuar masat kundër përhapjes së pandemisë. Ushtarët e sapo betuar iu nënsh-

“ 116 vajza dhe djem u betuan në Shkollën e Trupës në Bunavi, si ushtarët më të rinj të Forcave të Armatosura të Shqipërisë



truan tre periudhave të stërvitjes, asaj të gjelbër, blu dhe të kuqe.

Ushtarët e rinj i përgëzoi edhe shefi i Shtabit të Shkollës së Trupës, nënkolonel Bujar Fejzo, i cili falenderoi edhe personelin trajnues. "Kjo ditë është e veçantë, pasi u betuan si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, para flamurit tonë kombëtar, për t'i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit. Ndihe mi krenar për produktin e punës suaj, për këtë forcë të madhe ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet e vazhdueshme tuaja në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara

në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura".

Në veçanti, shefi i Shtabit i Shkollës së Trupës, falenderoi rekrutët e sapo çertifikuar: "Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar, për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi, jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t'ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin tuaj."

Pas betimit dhe titullimit si ushtarë apo detarë të Forcave të Armatosura, efektivët e rinj do të emërohen në forcat apo komandat e ndryshme.

Akademia e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake. Me qëllim vijimin e mëtijshëm të procedurave për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, të cilët do të ndjekin studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura, në linket e mëposhtëm dokumentacioni i nevojshëm:

Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, që do të ndjekin studimet në ciklin e parë "Bachelor" në "Shkenca Ushtarake" në Akademinë e Forcave të Armatosura, "Aneksi A"-Formulari i të dhënave personale të aplikantit, "Aneksi B"-Formular Vetëdeklarimi, "Aneksi C"-Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për oficerë aktiv. Pranimi në programin e studimit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar

"Bachelor" në Shkenca Ushtarake, 60 kandidatë për ciklin e parë



me sukses arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim, ku 60% të

vlerësimet e zë rezultati i konkurimit dhe 40% e zë rezultati i maturës shtetërore. Për t'u pranuar në këtë cikël studimi, aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta.

Qendra për Studime Universitare e FSK-së

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari", u zhvillua ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve gjatë periudhës 2016-2020.

Në fund të ceremonisë u ndanë diplomat për 15 kadetët e diplomuar nga ana e ministrit të Mbrojtjes të Kosovës, zotit Anton Quni. Në mesin e të diplomuarve ishte kadetja nga Republika e Shqipërisë Lirza Dollomaja e cila bazuar në rezultatet dhe performancën e dëshmuar, u dekorua edhe si "Kadetja më e dalluar" e gjeneratës 2020. Në emër të kadetëve të diplomuar me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti, kadetja Dollomaja e cila tha se me vendosmëri të madhe arritëm suksesin dhe se si oficerë do të jemi në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo në botë.

"Sot po bëhemi oficer në ushtrinë e paqes dhe stabilitetit, ashtu siç na mësuam prindërit dhe gjyshërit, një shkollë jete ku jo vetëm trajnohesh, shpërblehesh apo edhe ndëshkohesh,

Lirza Dollomaja nga Shqipëria u dekorua si "Kadetja më e dalluar"



ky është vendi ku bashkohet çdo trevë, çdo gjini e çdo karakter, për të vepruar si një trup i vetëm, për një qëllim më madhor, mbrojtjen e kombit", - tha Dollomaja.

"Pres që nga ajo që kam mësuar këtu ta rikthej dhjetëfish aty ku do të kthehem të shërbejë në vend. Shpërblimi si kadetja më e mirë ishte diçka që nuk e kam pritur, ndi-

hem shumë e privilegjuar, është një nder për mua të jem edhe kadetja e parë që diplomohet prej akademisë së Kosovës edhe e para kadete ndërkombëtare që diplomohet si kadetja më e dalluar", - u shpreh Dollomaja.

Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes Anton Quni, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rahman Rama, Drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATOs (NALT) gjeneral brigade Frank Best, U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes Faruk Geci, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, atashë ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarak bilateral, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar.

Procedurat e Rekrutimit për Oficerë

“Bachelor” në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura

Për vitin akademik 2020-2021 do rekrutohen 60 kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Ushtarake.

Akademia e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Ushtarake.

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Pranimi në programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Ushtarake është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim, ku 60% të vlerësimit e zë rezultati i konkurimit dhe 40% e zë rezultati i maturës shtetërore. Për t’u pranuar në këtë cikël studimi, aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

Të ketë shtetësi shqiptare; të kete

kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë; të mos jete i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë; të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.

Kritere të veçanta:

Të jetë i aftë nga ana shëndetësore; të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 cm për femrat; të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm pa mangësi apo shenja që deformojnë pamjen e jashtme; të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (semundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga semundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i levizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike; e) të mos jetë i martuar. Kandidati që nuk plotëson kriteret e përcaktuara më sipër skualifikohet.

Procedurat e aplikimit dhe konkurimit

Kandidatët që rezultojnë fitues nga konkurrimi në portal www.ualbania.al (matura shtetërore) për ndjekjen e programit “Bachelor” në Shkenca Ushtarake, paraqiten personalisht pranë Sekretarisë Mësimore të Akademisë së Forcave të Armatosura ku plotësojnë formularin e aplikimit për këtë program, si dhe paraqesin dokumentacionin përkatës. Kandidatët e rregjistruar i nënshtrohen



proçesit të testimit i cili konsiston: Ekzaminimin e gjendjes shëndetësore; Testim fizik; Intervistë; Procesi i testimit organizohet dhe drejtohet nga Komisioni ad hoc, bazuar në këtë rregullore dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese të këtij programi. Ky proces do të zhvillohet sipas parimit të mosdiskriminimit dhe të vlerësimit objektiv dhe të drejtës për aplikim, duke vlerësuar në mënyrë të paanshme të gjithë

Rektori jep përgjigje të motivuar, në formë të shkruar, brenda 7 ditëve nga paraqitja e ankesës.

Kandidati që nuk ka fituar mund të konkurrojë përsëri në vitin pasardhës.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatet që do të rekrutohen për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në "Shkenca Ush-

Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publikë në rrethet ku banojnë.

Në përfundim të konkurimit a) dëshmi penaliteti; b) vërtetim nga përmbartimi; c) vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor; d) vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.

Periodha e konkurimit

Afatet e konkurimit janë të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) nr. 02 datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programin e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të dytë të studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2020-2021".

Shënim: Personi që aplikon deklaron se të dhënat e paraqitura në formularë përkatës janë të vërteta dhe autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.



dokumentacionin e paraqitur dhe duke motivuar të gjitha rastet e mospranimit në këtë program studimi.

Shpallen fitues kandidatët që janë vlerësuar me numrin maksimal të pikëve në rend zbritës, deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit. Kjo kuotë bëhet publike që në fillimin e aplikimeve.

Kandidati fiton të drejtën për të filluar studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura në programin e studimit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake, kur regjistrohet në Sekretarinë Mësimore të fakultetit sipas udhëzimeve të dhëna nga MASR, në të kundërt, ai humbet të drejtën për ndjekjen e studimeve në AFA.

Lista e kandidatëve fitues për programin "Bachelor", shpallet në mjedise të dukshme në Akademinë e Forcave të Armatosura, websitin zyrtar të saj (www.tradoc.mil.al) dhe Ministrisë së Mbrojtjes (www.mbrojtja.gov.al).

Kandidatët që nuk shpallen fitues, kanë të drejtën e ankimit në Akademinë e Forcave të Armatosura, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve.

tarake" në Akademinë e Forcave të Armatosura, dhe rezultojnë fitues nga matura shtetërore, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: Në fazën e regjistrimit a) kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake; b) formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A, bashkëlidhur këtij dokumenti; c) formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore i cili plotësohet pranë AFA-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit. d) fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listen e notave; e) fotokopje e kartës së identitetit; f) certifikatë familjare, 1 copë; g) fotografi për dokument (4x6), 2 copë; h) raportin mjekoligjor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit; i) analizat e gjakut për Hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga



Projektligj për forcimin e disiplinës në FA

Cilat janë shkeljet disiplinore të lehta, të rënda dhe shumë të rënda?

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore, për nënoficerët dhe ushtarët e FA

Ministria e Mbrojtjes ka përgatitur projektligjin i cili forcon disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në fakt ky nuk është një projektligj i ri, por një përmirësim i atij ekzistues, pra ka disa shtesa e e ndryshime ne ligjin e vitit 2014. Madje projektligji i tanishëm, relacioni i të cilit është firmosur nga Ministria e Mbrojtjes, znj.Olta Xhaçka, titullohet "Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Projektligji i tanishëm mbështet në neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës. Në ligjin nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pas fjalës "...kursantët...", të shtohet fjala "...studentët...".

Neni 2

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Në pikën 1, fjalia e fundit e shkronjës "b" të ndryshohet, si më poshtë: "...shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore, për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me

përrjashtim të atyre të përcaktuar në paragrafin e dytë të shkronjës "c", të pikës 1 të këtij neni...". Në pikën 1, në shkronjat "c" dhe "ç", pas fjalës, "...batalioni...", të shtohen fjalët "...drejtuesi ushtarak në nivel njësie kryesore/njësie bazë në institucionet arsimore ushtarake...". Në pikën 1, në fund të shkronjës "c", të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje: "Komandantët e Forcave dhe strukturave mbështetëse, me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor, për masat shumë të rënda "Vërejtje me paralajmërim" dhe "Ulje në pagë", për tetarët dhe nëntetarët, si dhe për ushtarët me grada "Ushtar I deri Ushtar IV", në varësi të tyre. Pika 2 riformulohet dhe bëhet: "Ndaj oficerëve me grada madhore mund të jepen vetëm masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "dh" sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: në pikën 1, pas fjalëve "...në Shtabin e Përgjithshëm...", të shtohen fjalët "...dhe Komandat e Forcave dhe strukturave mbështetëse...".

Neni 4

Neni 11 ndryshon dhe bëhet: "Neni 11 Shkelje disiplinore të lehta 1. Shkelje disiplinore të lehta janë: veprimi në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi për ruajtjen e administri-

min e dokumenteve apo materialeve shkresore, elektronike dhe filmime; b) mosrespektimi i rregullave të nderimit, sipas shkallës hierarkike; mosdeklarimi i përdorimit të medikamenteve për arsye mjekësore, që krijojnë efekte në sjelljen ose aftësitë fizike të tij; publikimi i paautorizuar në rrjetet sociale të pamjeve personale apo të çdo efektivit të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak, simbole dhe mjete teknike ushtarake; mosrespektimi i orarit të punës; përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura për qëllime private gjatë apo pas kryerjes së detyrës, përjashtuar rastet kur është i autorizuar për këtë gjë; përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura pa dokumentacionin përkatës; përdorimi i paautorizuar i sendeve personale dhe ushtarake të ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura; përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private; g) mosraportimi i shkeljes disiplinore; gj) lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës ose mjetit tokësor, detar, ajror nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale; përdorimi i lojërave të bixhozit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale; i) pranimi i dhuratave ose ndonjë përfitimi nga vartësit apo personave të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi; mosdhënia e ndihmës ushtarakëve të tjerë të FA-së gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ato kanë nevojë për

ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet;

k) shkrepija e armës nga pakujdesia, e cila nuk shkakton dëme materiale apo lëndime njerëzore; mosmirëmbajtja dhe/ose dëmtimi i armës, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura nga pakujdesia, që shkakton humbjen e përkohshme të gatishmërisë teknike të tyre. Kryerja e shkeljes së tretë të lehtë disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet e rënda, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.”

Neni 5

Neni 12 ndryshon dhe bëhet: “Neni 12 Shkelje disiplinore të rënda 1. Shkelje disiplinore të rënda janë: a) kryerja e riteve fetare me uniformë, në institucionet fetare, jashtë ambienteve të Forcave të Armatosura; b) publikimi apo dhënia në media e informacioneve, që lidhen me veprimtarinë e FA-së, si dhe shpërndarja e dokumenteve zyrtare të paklasifikuara, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi; c) shprehja e kritikave publike ndaj FA-së, në formë shkresore, elektronike apo verbale, që cenojnë imazhin e institucionit apo personalitetin e ushtarakëve të tjerë të FA-së; ç) fshehja, ndryshimi, ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore, ose elektronike; d) dhënia me dashje e informacionit të gabuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislati në fuqi; dh) shkelja me qëllim e rregullave të mbajtjes, mirëmbajtjes, ruajtjes dhe përdorimit të armatimit, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura; e) mbajtja dhe përdorimi i armës nga ushtaraku i Forcave të Armatosura në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi; ë) mbajtja e armëve individuale private, me leje, në ambientet ushtarake; f) veprime, qëndrime apo shfaqje diskriminuese në bazë etnie, fetare, race, krahine, bindjeje politike, filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore; g) përdorimi i pijeve alkoolike gjatë punës/shërbimit apo në rastet kur është me uniformë, me përjashtim të aktiviteteve zyrtare; gj) dhënia e uniformës me shenjat dhe simbolet dalluese ushtarake, dokumentit të Forcave të Armatosura, ose pajisjeve të tjera ushtarake personave të tjerë; h) mba-

jtja e uniformës ushtarake në lokale nate, kazino, lojëra fati dhe në ambiente të tjera të ngjashme me këto; i) mungesa, mosparaqitja në shërbim/punë apo largimi nga vendi i shërbimit/punës, pa arsye të justifikuar deri në 5 ditë, për ushtarët dhe deri në 7 ditë, për oficerët dhe nënoficerët; j) mosparaqitja në punë apo shërbim jashtë orarit të përcaktuar, kur i kërkohet nga eprorët e tij, pa arsye të justifikuar; k) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme, ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga



i dëmtuari; l) ngacmimet seksuale, në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale, të kryera gjatë, ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbëjnë vepër penale; ll) shkelja e rregullave të shërbimit, kur nuk përbën vepër penale; m) rezistenca ndaj procedimit disiplinor, ose refuzimi i kryerjes së masave disiplinore; n) përkrahja apo ndihma në kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në këtë ligj, ose pengimi apo parandalimi për kapjen, gjykimin a dënimin e ushtarakut, i cili ka kryer një shkelje të dënueshme nga ky ligj; nj) mosmarrja e masave të nevojshme për ndërprerjen e shkeljes disiplinore që po kryhet nga vartësit e tij dhe/ose për parandalimin e pasojave të mëtejshme që mund të vijnë prej saj; o) kryerja, ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me legjislatin në fuqi, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës. p) dëshmia e rreme gjatë procedimit disiplinor; q) mosraportimi i përdorimit të armës së zjarrit; r) mosrespektimi i orarit të punës më shumë se një herë brenda një periudhe njëvjeçare; rr) ushtrimi i presionit ndaj vartësve për përfitime personale, kur

nuk përbën vepër penale; s) prishja e qetësisë në njësi, ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale; sh) moszbatimi i detyrave të dhëna nga eprori i drejtpërdrejtë; t) mbajtja në mënyrë të parregullt, ndryshimi, ose keqpërdorimi i uniformës dhe shenjave ushtarake; th) “Ngacmim” në çdo formë sjelljeje të padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes

për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë. u) veprime me dashje, të cilat çojnë në paaftësi fizike të vetë ushtarakut, me qëllim shmangien nga detyrat e ngarkuara. 2. Shkeljet disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “k” dhe “l” të pikës 1, të këtij neni, të kryera gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes, misionit jashtë vendit apo të kryera nga oficerët me grada madhore, kategorizohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe masat përkatëse jepen sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 14 të këtij ligji. 3. Kryerja e shkeljes së tretë të rëndë disiplinore, brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet shumë të rënda, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.”

Neni 6

Neni 13 ndryshon dhe bëhet: “Neni 13 Shkelje disiplinore shumë të rënda 1. Shkelje disiplinore shumë të rënda janë: a) mbështetja e fush-

atës së një partie ose organizate politike apo e një anëtar të një partie politike ,ose të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë fizikisht ,ose duke kontribuar financiarisht; b) ndihma, përkrahja ,ose pjesëmarrja në aktivitete të organizatave politike, fetare ose jofitimprurëse, gjatë orarit të punës, në vendin e punës ,ose në mjetet ushtarake, si dhe në rastet kur mban uniformën ushtarake, ose shenja të saj; c) lejimi i personave nga organizata politike, fetare apo çdo organizatë tjetër jofitimprurëse të bëjnë propagandë në ambientet e Forcave të Armatosura dhe në mjetet që ato disponojnë; ç) përdorimi, shpërndarja apo vendosja në mjetet ,ose në ambientet ku shërbejnë Forcat e Armatosura e simboleve apo reklamate të organizatave, politike apo shoqërore, me përjashtim të atyre me karakter humanitar; d) ushtrimi i funksioneve, ose mospërmbushja e detyrave që sjellin cenim të operacionalitetit, gatishmërisë dhe sigurisë në Forcat e Armatosura; dh) organizimi, nxitja apo pjesëmarrja në grevë; e) përdorimi i substancave të paligjshme dhe lëndëve narkotike, kur nuk përbën vepër penale. ë) dhënia ,ose mundësimi i dhënies së informacioneve me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës, ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme, personave të paautorizuar ,ose medias, kur nuk përbën vepër penale; f) ngacmimet seksuale, në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale, të kryera nga eprori ndaj vartësit ose ndaj ushtarakut me gradë më të ulët, gjatë ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbën vepër penale; g) organizimi i lojërave të bixhazit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale; gj) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ,ose tentativa për ushtrim dhune, sjellja fyese apo kërcënuese ndaj një personi tjetër, kur kjo ushtrohet nga oficerët aktivë me grada të larta ose madhore të FA-së ose kur kryhet ndaj eprorit të drejtpërdrejtë, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari; h) refuzimi i zbatimit të urdhrorit apo një vendimi të ligjshëm të dhënë nga eprori. i) mosmarrja e masave të duhura të organizimit dhe sigurisë nga drejtuesit e një-sive dhe reparteve të FA-së, kur kjo ka sjellë pasoja të rënda materiale;

j) përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin dhe/ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët, për çfarëdolloj arsyeje, pa dijeninë e tyre, kur nuk përbën vepër penale dhe përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “ç) “Stërvitje disiplinuese”, e cila është masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura brenda natyrës së elementeve të stërvitjes, të tilla si; vrapim, pompa, palosje, apo ndonjë stërvitje tjetër të përshtatshme gjatë orarit të punës”. Kjo masë jepet ndaj ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve deri në gradën kapiten”. 2. Pika 3 ndryshohet dhe bëhet: “Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje shumë të rënda, janë: a) “Vërejtje me paralajmërim”, e cila është masa me shkrim, e motivuar, drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura, për lirim nga Forcat e Armatosura; b) “Ulje në detyrë”, e cila është një masë nëpërmjet së cilës, ushtaraku emërohet në një detyrë të përcaktuar për t’u ushtruar nga një ushtarak me gradë më të ulët, për jo më shumë se një vit. c) Ulje e pagës, e cila është masë, nëpërmjet së cilës ushtaraku do të trajtohet me pagën e deri një grade më të ulët për jo më shumë se një vit; ç) “Ndalimi për gradim”, e cila është masa që ndalon ushtarakun për të konkurruar për marrjen e gradës së rradhës, vetëm 1 herë. d) “Ulje në gradë” e cila është një masë nëpërmjet së cilës, ushtaraku ulet deri në një gradë, por jo më shumë se 1 vit. Në fund të vitit, ushtaraku rimerr gradën e mëparshme. dh) “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”, e cila është masë ekstreme e dhënë për shkelje shumë të rënda disiplinore”.

Neni 8

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime: Pika 2 ndryshohet, si më poshtë: “2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e

përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 14 të këtij ligji.” Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5, si më poshtë: “3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 14 të këtij ligji. 4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të nenit 14 të këtij ligji. 5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.”

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime: Në pikën 1, shkronja “gj” riformulohet, si më poshtë:

“gj. Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes apo misionit jashtë vendit”. Në pikën 1 të shtohen shkronjat “h”, “i” dhe “j”, me këtë përmbajtje: “h. Kryerja e shkeljes disiplinore nga oficerë me grada të larta”. i. Kryerja e shkeljes disiplinore në situatë lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore; j. Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë operacioneve apo misioneve brenda vendit.”

Pika 2 ndryshohet, si më poshtë: “2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 14 të këtij ligji.”

Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5, si më poshtë: “3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 14 të këtij ligji. 4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 3, të nenit 14 të këtij ligji. 5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.”

Në kuadrin e 100 vjetorit, lufta e Dibrës 1920

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Organizimi i rezistencës së armatosur

Një pjesë e territorit të qarkut të Dibrës ndodhej e pushtuar nga serbët prej vitit 1918, kur ushtria austro-hungareze u tërhoq me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Ushtria serbe përpigjej të mbante vijë kufiri "strategjik" pozicionet Qafat Llangë, Buall, Murrë dhe Lanën e Lurës. Ajo kishte kaluar kufirin e përcaktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913 dhe mbante të pushtuar pjesën më të madhe të krahinës. Ushtria serbe në këto territore të pushtuara kishte përqëndruar forca në rajonet, Dibër e Poshtme 6 batalione, Gollobordë dy batalione dhe në Bulqizë një batalion. Komanda ushtarake serbe duke përfutur nga situata e vështirë politike e ushtarake në Shqipëri të përjetësonin pushtimin e krahinës së Dibrës në vijën e kufirit të pretenduar "strategjik" prej tyre. Në bashkëpunim dhe me forcat esadiste krijuan shqetësime për shtetin shqiptar në Dibër. Gjendja politike, ekonomiko dhe ushtarake e krahinës paraqitej e ndërlikuar. Krahina ishte plaçkitur, djegur mjaft herë dhe pasuria e të gjithë fshatarëve ishte dëmtuar rëndë. Fshatarësia vuante nga dhuna e ushtruar prej serbëve dhe në masë ishte bërë çarmatosja e popullatës. Kudo në fshatra ishte ushtruar dhunë dhe kjo e shoqëruar me masakra të përgjakshme në fshatrat Kala e Dodës, Trebisht, Peladhi, Sopot, etj., ku ishin vranë mjaft fshatarë duke i shantazhuar për të dorëzuar armët. Kjo çarmatosje masive e popullatës rëndoi shumë në ekonominë fshatare, pasi pushtuesi i detyroi me forcë të punonin në ndërtime ushtarake, në transportin e municioneve etj. Forcat patriotike shqiptare e vlerësuan realisht qëndresën e popullit dibran të pushtuar nga ushtria serbe dhe nisën përpjekje për luftë.

Qeveria e Sulejman Delvinës e vlerësoi rrezikun serb në Dibër, por në kushtet konkrete që po kalonte Shqipëria me Luftën e Vlorës dhe të Koplikut, nuk dëshironte një konflikt me shtetin serb. Shpresonte zgjidhje me ndërhyrje të diplomacisë europiane, por më parë të zgjidhej konflikti me Italinë. Në këtë kohë pozitën e shtetit shqiptar në arenën

ndërkombëtare ishte ende e pa konsoliduar. Konflikti me serbët do kishte pasoja të dëmshme. Në këto kushte forcave patriotike dibrane ju shtrua si domosdoshmëri organizimi i rezistencës së armatosur. Vepri i luftarake kundër ushtrisë serbe ishte përqëndruar në fshatrat Arras, Vajkal dhe Steblevë. Ishte krijuar një vijë fronti në Dibrën e Poshtme duke filluar nga Ura e Dodës, Ura e Topojanit, gjatë lumit Drin i Zi, Bulqizë, Zall Murë dhe Kulla e Shabës, ndërsa nga Golloborda në Zall të Okshtunit dhe në Shkallë të Borovës, pritej momenti i përshtatshëm për të kaluar në sulm. Qëndresa e popullatës kundër ushtrisë serbe nxitte lëvizjen patriotike në zonën e pushtuar, për të filluar përgatitjen për kryengritje. Ushtria serbe largohej nga territori shqiptar vetëm me luftë të armatosur, kështu mendonte lëvizja patriotike në Dibër. Ushtria serbe, në vijim bënte reprezalje për ta stepur lëvizjen patriotike dhe dobësuar qëndresën e armatosur. Nga fundi i majit 1920 ushtria serbe ndërmori një reprezalje të përgjakshme në Kalanë e Dodës, krahinë luftarake duke vranë e therur mjaft fshatarë, deri gra, pleq e fëmijë, dogjën shtëpi dhe grabitën bagëti. Këto vandalizma rritën zëmërimin e popullsisë ndaj pushtuesit. Përpjekje me armë u shfaqën dhe në sektorin e Bulqizës, ku u organizua në çeta, në Vajkal me komandant Mehmet Duriçi, që ruante territorin dhe nuk lejonte ushtrinë serbe të shkelte vijën strategjike. Në zonën e Gollobordës e në Zabzum, ushtria serbe u shpartallua nga qëndresa e çetave.

Forcat kryengritëse dhe komanda ushtarake

Jehonë në masat fshatare të Dibrës dhe në qarqet patriotike bëri fitorja e Luftës së Vlorës kundër italianëve. Patrioti Ismail Starzimiri ka shkruar se trimëria e pashembullt e treguar nga shqiptarët në luftën e përgjakshme që zhvillohej me ushtritë italiane dhe rezultatet e arritura prej tyre ngjallën një shpresë së madhe dhe një entuziazëm e guxim të papërshtatshëm, shtuan besimin në forcat e masave popullore edhe të kësaj krahine. Patriotët dibranë në Tiranë të përfaqësuar nga deputeti Ramiz Daci dhe patrioti Ramiz Dibra, i kërkuan qeverisë së Sulejman Delvinës për të organizuar administratën e prefekturës në Dibër. Në

fund të korrikut 1920 në fshatin Arras të Peshkopisë u vendos administrata e krahinës me prefekt Ramiz Dibrën. Administratë krijoi lidhje me krahinat e pushtuara dhe filloi përgatitjen për luftë të armatosur. Në "besën e përgjithshme" të krahinës vëmendja u drejtua për luftën kundër pushtuesit serb. Autoriteti i Prefekturës u rrit shumë. U krijua dhe komanda ushtarake me komandant Elez Isufi. Komanda shqyrtoi dislokimin e forcave armike dhe caktoi zonën e luftimit për çdo çetë. Ushtria serbë kishte kapur në pika dominuese në krahinë. Batalionet ushtarake serbe ishin të vendosur në Dibrën e Poshtme, shtabin kryesor e kishin ngritur në Kodrat e Llasenit, në jug të Peshkopisë. Forcat ushtarake i kishin përqëndruar në Majë të Llogorit, te Lisat e Tnenës, në Smollaviç, në Kodër të Bullgarit, në Qafë të Kërnelit, që të gjitha në territorin e fshati Dohoshishtë. Në veri dhe në verilindja ishin vendosur në Gjarica të Brezhdanit, në Kodër të Kabe, në Pasma të Kishavecit, në Ostësh të Laçes, në Kodër të Kshtejës të katundit Kastriot, në Salbatër të Fushalies, në Shkeka të Shumbatit dhe në Kala të Dodës.

Forcat kryengritëse nga fshati Arras më 13 gusht 1920 i dërguan një ultimatum komandës ushtarake serbe ku i kërkohej që brenda 24 orëve të tërhiqeshin. Komanda ushtarake serbe nuk pranoi. Atëherë sipas planit luftarak të përpunuar më parë, u vendos të sulmohej ushtria serbe e përqëndruar në "Shkeka të Shumbatit" e pastaj në të gjithë gjithë krahinën. Sulmi do kryhej nga çetat e Ujës, Reçit e Dardhës nën komandën e Suf Xhelilit, nipit të Elez Isufit, të cilëve do t'u shkonin në ndihmë forcat e Arrasit. Pozicioni gjeografik i Kodrinës së Shkekës paraqiste vështirësi të mëdha për ta sulmuar. Luftëtarët nga çdo anë që të ndërmerrenin luftimin do gjendeshin të zbuluar dhe nën zjarrin e armëve serbe. Ushtria serbe ishte fortifikuar, kishte hapur transe dhe pajisjet luftarake ishin futur në tokë. Pozicionet kryesore ruheshin nga disa pozicione të përparuara. Në këtë fortifikatë ushtria serbe kishte vendosur katër topa me rreze veprimi të gjatë. Marrja e këtij pozicioni ishte vendimtare për kryengritësit. Marrja e kësaj fortifikate u studiua dhe u përgatit me shumë kujdes. U vendos që së pari të goditeshin natën pikat e përparuara, pa zhurmë dhe t'i afroreshin në fshehtëzi objektivit. Çeta e Ujës e komanduar nga Suf

Xhelili kapi postën serbe në katundin Shumbat të sulmuar në befasi, duke dalë pa u diktuar në Shkeka, ndërsa çetat e Reçit dhe Dardhës asgjësuan postën në Zall Kalisit dhe dolën në Shkekë nga veriperëndimi.

Sulmi i çetave "o besa besë"

Në mëngjes pa zbardhur drita nisi sulmi. Luftëtarët i mashtruan ushtarët serbë me sulme të rreme, me britma të fuqishme "o besa besë", iu afruan pozicioneve të fortifikuara. Zjarri i armëve të serbëve ishte shumë i dendur dhe terreni mjaft i disfavorshem. Luftëtarët nuk e ndalën sulmin dhe u hodhën në llogoret armike. Pas sulmit në Shkeka filluan dhe sulmin çetat në Arras, Fshatarët e Çidhnës e një pjesë të Dardhës të komanduara nga Elez Isufi. Këto çeta kaluan lumin Drin të Zi nën goditjen e artilerisë serbe, ku përshkuan me shpejtësi Fushalien, ku u ndanë në dy grupe sulmuese. Grupi i parë sulmoi Salbatrën, poshtë Shkeka të Shumbatit. Grupi i dytë sulmoi në kah të Ostushit nga jugu. Grupi që sulmoi Salbatrën i detyroi forcat serbe të tërhiqen. Me tërhiqjen e forcave serbe çetat nisën përgatitjet për të sulmuar në Shkeka. Ushtria serbe në Shkeka të Shumbatit bëri një qëndresë, por sulmi i çetave të përqëndruara ishte tepër i shpejtë dhe masiv. Në llogore u bë luftim trup me trup. Ushtria serbe u largua në panik, ku la në fushën e betejës sipas të dhënave mbi 1.000 robë e të vranë. Në këtë betejë u shqua luftëtari Osman Tahir Paci, i cili ra dëshmor. Edhe sulmi i çetave të Muhërrit dhe të fshatrave të Kastriotit kundër Çapit të Brezhdanit dhe më tej edhe marrjen e Gjanicës nga luftëtarët. Forcat serbe gjatë kësaj kohe nuk u lanë të qetë dhe në prapavijat e tyre. Forcat serbe të përqëndruara në Kodër të Kabe, nga sulmet e vijueshme të çetave të zonës u detyruan të tërhiqen në drejtim të Zimurit, ku dhe u likuiduan plotësisht. Në pritën e organizuar nga këto çeta luftoi si një hero luftëtari Melaim Kulemam, ku dhe ra dëshmor. Edhe forcat serbe të përqëndruar në Kodër të Pollozhanit, u goditën nga çetat dhe u detyrua të ikin në drejtim të malit Skërtec, por edhe këto forca u likuiduan nga pritat që i bëri çeta e fshati Rabdisht. Goditje e fuqishme ju dhe foracve serbe të përqëndruara në afërsi të qytetit të



Peshkopisë. U godit shtabi serb në Kodrinat e Llasenit. Sulmi i çetave të Dohoshishtit dhe të Grevës, i vendosi forcat serbe midis dy zjarreve. Forcat serbe u tërhoqën në panik dhe lanë në duart e luftëtarëve dibranë topat, mitralozët dhe mjaft të vranë e robër. Forca serbe edhe në Dibër të Poshtme u sulmuan nga çetat e Vajkalit dh të Steblevës. Në datën 15 gusht 1920 forcat serbe me luftime të vazhdueshme prej çetave të luftëtarëve dibran u larguan nga kufiri i vitit 1913, duke lënë të vranë, robër, armë e municione, të gjithë topat dhe dhjetëra mitralozë, etj.

Forcat kryengritëse dibrane në këto luftime zbatuan disa nga parimet e artit ushtarak shqiptar të trashëguar në shekuj. Luftëtarët dhe drejtuesit e tyre realizuan me sukses sulme të rrufeshme, goditën natën, përdorën mashtrimin, sulmet u gërshtuan njëkohësisht me veprime në prapavijë të tij, u shfrytëzua mjaft mirë njohja e terrenit dhe rezervat e luftëtarëve u hodhën në luftime në kohën e duhur. Gjithashtu luftëtarët shqiptarë dhe drejtuesit e tyre patën një bashkëpunim të mirë me forcat maqedonase që nuk ishin dakord me politikën e Serbisë. Pjesëmarrja masive e popullit në luftë ishte një faktor vendimtar dhe me rëndësi për suksesin e arritur në veprimet luftarake. Në Luftën e Dibrës ranë disa dëshmorë: Osman Paci nga Fushalia, Melaim Kulemani nga Zimuri, Osman Fali Pitarka nga Grykë Noka, Hasan Ali Tola nga Çidhna, Shazuman Emin Fishti nga Vranjti, Tahir Duriçi, Adem Duriçi e Hasan Duriçi nga Vajkali dhe Tahir Hoxha nga Sopotit. Gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake kontribut të shquar dhanë dhe gratë e Steblevës e Vajkalit, si Gjyle Hoxha, Hatixhe Kolmaku, Nesle Kormaku, Sulltane Hoxha, Zylfie Murati, Zyle Tonçi, Hike Dedja, Hajrie Hysa etj., që shkonin në pozicionet e luftëtarëve dhe u çonin ushqime municione, ujë, kryenin detyrën e korrierit. Ndërsa luftëtarja Hajrie Hysa luftoi së bashku me burrat. Në qytetin e Peshkopisë u vendos administrata e prefekturës me Ramiz Dibrën. Forca ushtarake ishte e kufizuar dhe në gatishmëri qëndronin çetat e fshatarëve. Detyrë urgjente për administratën ishte ruajtja e kufirit. Këtë detyrë e morën përsipër luftëtarët e fshatarave kufitare duke u vendosur në pika të ndryshme të terrenit. Nga administrata e prefekturës pati mungësi organizative, ajo u gjend në vështirësi të mëdha dhe Qeveria e Tiranës nuk kishte mundësi të dërgonte forca ushtarake për sigurimin e kufirit. Qeveria serbe përgatiti forca të shumta ushtarake dhe në fund të gushtit 1920 sulmoi gjithë vijën e kufirit me mbi 40 batalione, të pajisura me armë nga më të rëndat e kohës. Ushtria serbe ndeshi në qëndresën e luftëtarëve dhe sulmi nuk pati sukses për tri ditë me rradhë.

Qëndresa e luftëtarëve dibranë

Luftëtarët dibranë të armatosur me pak fishekë, por të vendosur që ta mbronin me çdo kusht kufirin e atdheut, u bënë ballë heroikisht ushtrive të panumërta serbe. Në Skërtec, në Rabdisht, në Carakol, në porta të Korabit e në Gjegje të Bushtricës ranë dëshmorë

për mbrojtjen e kufirit me dhjetëra fshatarë të cilët luftuan me vendosmëri për mbrojtjen e tërësisë tokësore të shtetit shqiptar: si Halim Shaqir Leska, Naxhie Ali Murraku e Shaban Ali Dedanga katundi Ploshtan, Dali Ibrahim Koka nga Kalisi, Abaz Jakup Baloshi nga Radomira, Halil Bajram Hysenaj e Murat Bajram Hysenaj nga Kraj Reçi, Halil Zenel Doçi nga Kastrioti, Rushit Xhil Spata, Xhil Bajram Tota e Rexhep Sadik Tota nga Blliqe, Xhaferr Lokë Loka nga Sinja e Epërme, Allaman Ali Salkurti nga Rashnapoja, Lush Bunguri nga Greva, Vahide Rushit Tola nga Çidhna, Zahide Tavanja nga Arrasi, Ismail Jashar Bodurri nga Okshatira, Sherif Ismail Bali nga Sohodolli, Abdulla Ibrahim Cara nga Bardhaj Reçi e sa e sa të tjerë. Luftëtarët dibranë pas një qëndrese të fortë, u tërhoqën drejt perëndimit, përtej Drinit të Zi. Popullata pjesërisht u tërhoq drejt Tiranës e drejt Matit, kurse një pjesë e konsiderueshme u strehua në shpellat e zonës së Çidhnës. Ushtritë serbe, pasi thyen përkohësisht rezistencën e fshatarëve, dogjën gjithë krahinën dhe ndërmonën për hakmarrje, vrasje e masakra. Gjendja e Dibrës tërhoqi vëmendjen e krahinave të tjera të afërta. Elbasani u interesua dhe mbështeti fuqimisht qëndresën e krahinave kufitare të Gollobordës e të Bulqizës si duke i organizuar e armatosur emigrantët dibranë, ashtu edhe duke dërguar Forca të Armatosura në afërsi të vendeve ku bëheshin veprime luftarake.

Interes tregoi edhe krahina e Matit, meqë, pasi të përfundonte pushtimi i Dibrës, ushtritë serbe do të futeshin në zonën e tyre, prandaj shpesh vajtën në ndihmë dhe mbështetën qëndresën në Vajkal e në Qafmurrë. Për lëvizjen patriotike të Dibrës u interesua veçanërisht "Komiteti i Kosovës", i cili përpiqej të bashkërendiste veprimtarinë ushtarake të të gjitha krahinave të pushtuara nga serbët. Kjo taktikë nuk gjeti aprovimin e qeverisë së Sulejman Delvinës, sepse ky nuk e shihte të përshtatshme organizmin e lëvizjes së armatosur. Pushtimi serb e vuri në gjendje të vështirë shtetin e ri shqiptar. Për ndaljen e ofensivës së tij u mobilizuan të gjitha krahinat e Shqipërisë së Veriut dhe me luftë të armatosur nga njëra anë e me anë bisedimesh nga ana tjetër u arrit që të dëbohej armiku nga zona e pushtuar. Qarqet shoviniste serbe u përpoqën t'i shfrytëzonin bisedimet për ta detyruar qeverinë shqiptare që të ndiqte një politikë projugosllave, nuk patën sukses. Qeveria e S. Delvinës iu drejtua me një notë Fuqive të Mëdha ku kërkonte tërheqjen e trupave të huaj nga toka shqiptare dhe të njëjhej tërësia tokësore e shtetit shqiptar.

Kryengritja e gusht-shtatorit e 1920-s e bërë nga populli i Dibrës kundër pushtuesit serb luajti një rol të rëndësishëm, ku u shtua dhe u forcua edhe më shumë ndjenja e patriotizmit, spikati trimëria, guximi deri në vetëmohim dhe heroizmi masiv i luftëtarëve dibranë që në kushtet e pushtimit, pa marrë parasysh sakrificat në njerëz dhe në ekonomi, u përleshën me një ushtri të rregullt, të armatosur më së miri dhe në numër shumë herë më të madh.



KAZERMA "ADEM JASHARI"

Diplomohen 15 kadetët e gjeneratës 2020

Ministri Quni: "Unë besoj se ju edhe më shumë do t'i forconi urat e miqësisë me SHBA-në dhe partnerët tjerë strategjikë"

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari", u mbajt ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve gjatë periudhës 2016-2020. Në ceremoninë e organizuar me pjesëmarrje të kufizuara për shkak të masave kundër COVID-19, morën pjesë ministri i Mbrojtjes Anton Quni, Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ish-kryeministri i vendit Ramush Haradinaj, Drejtori i Ekspertizës dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) gjeneral brigade Frank Best, U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes Faruk Geci, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, atashë ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarak bilateral, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar. Pas nderimit të flamurit, me fjalë përshëndetëse, të pranishmëve iu drejtua, nikoqirja e ceremonisë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), komandë brenda së cilës vepron edhe QSU, gjeneral brigade Irfete Spahiu. Gjeneral Spahiu pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, u rikujtoi kadetëve rrugëtimin e përbashkët me të gjitha strukturat e komandës që udhëheq për të realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. Ajo, në mesazhin e urimit shprehu besimin për sukseset e kadetëve edhe në vazhdim të karrierës së tyre si oficerë ushtarak, gjithnjë me moton "E ardhmja fillon këtu". "Po bëhen më shumë se dy dekada nga koha kur populli i këtij vendi u çlirua dhe më shumë se dy dekada kur unë vendosa të bëhem pjesë e ushtrisë, por ajo çka nuk ndryshon asnjëherë të një ushtarak është për të kontribuar për atdhe dhe jo vetëm në kohë lufte, por edhe paqe." tha ndër të tjera ajo.



Nga ana e tij, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, në mesazhin e tij drejtuar kadetëve të diplomuar, i inkurajoi të qëndrojnë konsistentë në realizimin e synimeve me frymën dhe shpirtin luftarak, gjithmonë duke ruajtur prestigjin e FSK-së dhe vlerat themelore të ushtarakut, si Detyrën, Nderin dhe Atdheun. "Detyra, Nderi dhe Atdheu janë vlerat që do t'ju vendosin nga kjo ditë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim, vlera këto që janë tashmë të ngulitura në zemrat tuaja", -tha ndër të tjera gjeneral Rama. Ai gjithashtu, shprehu falenderimin për partnerët tanë të cilët me mbështetjen e madhe mundësuan zhvillimin dhe avancimin e QSU-së, me programe të akredituara në gjuhën angleze sipas standardeve më të avancuara të vendeve partnere, anëtare të NATO-s, për çka edhe kanë ofertën e hapur për të sjellë kandidatë të tyre për studime në Qendrën tonë.

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, në adresimin e tij para të pranishmëve, iu drejtua kadetëve të diplomuar duke i theksuar me emra të përveçëm. "Jo pa qëllim po i theksoj emrat tuaj. Dua këta emra t'i dëgjoj çdo qytetarë dhe të kuptohet se pse ju jeni të veçantë dhe pse ky moment është i veçantë", -theksoi ministri Quni. Si ish-ushtarak karriere, ministri Quni u rikujtoi kadetëve rrugëtimin me përplot sprova e sfida gjatë studimeve si testet e stërvitjes për qëndrueshmëri morale e kalitje fizike, përballja me kushtet e mbijetesës, marshimet e gjata e të mundimshme, e deri te leksionet e provimet e shumta profesionale e akademike gjithnjë me të jetuar nën regjimin e rreptë të disiplinës ushtarake. Duke shprehur besimin e plotë në suksesin dhe fitoren e garantuar të tyre në përmbushjen e misionit gjatë shërbimit si lider ushtarak, ai tha

kjo do të arrihet nga ju gjithmonë, sepse udhëhiqeni nga vlerat e shenjta të ushtarakut, Detyrës, Nderit dhe Atdheut". "Unë besoj se ju edhe më shumë do t'i forconi urat e miqësisë me SHBA-në dhe partnerët tjerë strategjikë. Falenderimi dhe mirënjohja është dhe do të jetë e përjetshme për NATO-n dhe miqtë tanë që në kohërat më të vështira n'a qëndruan pranë. Prandaj përgatituni që të zbarkoni edhe jashtë vendit, që me gatishmërinë tonë profesionale dhe morale ti shërbejmë njerëzimit dhe paqes kudo ku ka nevojë. Çdo kund dhe në çdo kohë barteni në vete dashurinë e Nënës Terezë, urtësinë e Presidentit Rugova dhe guximin, trimërinë dhe sakrificën e Adem Jasharit dhe familjes Jashari", -tha ministri Quni. Në fund, ai theksoi se, synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO dhe shprehu bindjen e plotë se me kuadro të këtitlla, pavarësisht sfidave gjeopolitike të çastit, e ardhmja euroatlantike e vendit është e sigurt.

Ceremonia vazhdoi me ndarjen e diplomave për 15 kadetët e diplomuar nga ana e ministrit Quni, gjeneral Ramës dhe gjeneral Spahiut. Në mesin e të diplomuarve ishte kadetja nga Republika e Shqipërisë Lirza Dollomaja e cila bazuar në rezultatet dhe performancën e dëshmuar, u dekorua edhe si "Kadetja më e dalluar" e gjeneratës 2020, ndërsa me motivacionin e njëjtë, u dekorua edhe "Instruktori më i dalluar" i QSU-së, toger Shpend Halimi, i cili në emër të kadetëve të diplomuar, me një fjalë rasti, përshëndeti të pranishmit. Kadetja Dollomaja, -tha se me vendosmëri të madhe arritëm suksesin dhe si oficerë do të jemi në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo në botë.



Me rëndësi është integrimi i komuniteteve në MM dhe në Forcën e Sigurisë

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, priti në ditën e parë të punës, zëvendësministren e Mbrojtjes nga radhët e komuniteteve jo shumicë, znj. Sadika Kofrc, pas marrjes së detyrës me vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Abdullah Hoti. Zëvendësministria Kofrc shoqërohej edhe nga deputetja e Parlamentit të Kosovës, Duda Bale nga radhët e komunitetit boshnjak. Në pritje ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rahman Rama, sekretari përgjithshëm Faruk Geci dhe shefi i Kabinetit të Ministrit Jashar Ramadani.

Ministri Quni, me këtë rast i dëshiroi mirëseardhje zëvendësministres Kofrc, të cilën e njoftoi mbi procesin e deritashëm të zhvillimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe me objektivat e përgjithshme për të ardhmen. Ministri Quni, gjithashtu e njoftoi ministren Kofrc, edhe me integrimin e pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ai e cilësoi si shumë të rëndësishëm emërimin e zëvendësministrit të ri të Mbrojtjes, nga radhët e komunitetit boshnjak, dhe të cilën e përgëzoi dhe njëherësh i prem-

Prezantohet Sadika Kofrc, zëvendësministre e Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuese e komunitetit boshnjak

toi bashkëpunim në realizimin e detyrave të përgjithshme. Nga ana e saj, zëvendësministria Sadika Kofrc, falenderoi ministrin Quni për pritjen dhe gatishmërinë për ta përkrahur gjatë kryerjes

së detyrave si zv. ministre e Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo u zotua se do të angazhohet me të gjitha kapacitetet e saja në përmbushjen e të gjitha objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Shkolla e Xhenios Luftarake e Forcave të Armatosura të Turqisë

Nëntoger Paçarizi përfundon Kursin Bazik për Xhenio Luftarake

Në Komandën e Shkollës së Xhenios Luftarake të Forcave të Armatosura të Turqisë në Izmir, pas shkollimit 6 mujor, prej datës 13 janar deri më 3 korrik 2020, oficeri i FSK-së, nëntoger Bener Paçarizi ka përfunduar me sukses Kursin Bazik për Xhenio Luftarake.

Në kursin përkatës gjashtë mujor, nëntoger Paçarizi u diplomua me sukses, në mesin e 120 kursantëve, ku përveç kursantëve nga vendi pritës, kursin përkatës e ndoqën edhe 13 kursantë nga 7 vende të ndryshme të botës. Ky sukses është edhe një vlerë e shtuar në kapacitetet e FSK-së, me kadro specialiste të nevojshme për ngritjen dhe avancimin e aftësive profesionale të FSK-së, në funksion të përmbushjes së misionit të ri, si forcë ushtarake dhe detyrave ligjore të saj.



QENDRA E EKSELENCËS PËR UDHËHEQJE, PËR NËNOFICERË NË SHBA:

Dy nënoficerë përfunduan kursin e rreshter majorëve në SHBA

Radhëve të rreshter majorëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kryen kursin e rreshter majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), më 19 qershor 2020, iu shtuan edhe Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani, të cilët përfunduan me sukses Kursin e Rreshter Majorëve në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për nënoficerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Bazën Fort Bliss në El Paso në Teksas.

Ky institucion më herët ka qenë i njohur si Akademia e Rreshter Majorëve. Kursi i Rreshter Majorëve është program 12 mujor, që përgatit Rreshter-Major, për principet e lidershit, për udhëheqjen e trupës së nënoficerëve, për këshillimin e nivelit të lartë të oficerëve lidhur me funksionimin e trupës së nënoficerëve, për ekzekutimin e operacioneve të përbashkëta tokësore, duke përfshirë të gjitha degët e ushtrisë Amerikane si dhe operacionet ndërkombëtare në bashkëpunim me agjenci të ndryshme. Shkollimi i oficerëve të FSK-së,



është mbështetur nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim pranë Ambasadës së SHBA-ve, në Kosovë. Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani gjatë shkollimit në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficerë në SHBA, treguan disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm,

si dhe e përfunduan me sukses të lartë Kursin e Rreshter Majorëve, klasa 70. Diplomimi i dy rreshter majorëve në përgjithësi është një e arritur e radhës për FSK-në, ku deri më tani në këtë Akademi të rreshter majorëve, kanë diplomuar me sukses të dalluar gjithsej shtatë oficerë të FSK-së.

Shkolla e Artilerisë dhe Raketave në Polatli të Turqisë

Nëntogeri Kushtrim Hoxha diplomohet në kursin bazik për Artileri

Nëntogeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) Kushtrim Hoxha nga Prizreni, pas përfundimit të kursit bazik për artileri, nga data: 13.01.2020 e deri më 13.07.2020 në mesin e 382 kursantëve, u diplomua me sukses të lartë në Shkollën e Artilerisë dhe Raketave në Polatli të Turqisë. Në këtë kurs ishin gjithsej edhe 17 kursantë të huaj nga të cilët oficer Hoxha zuri vendin e 3-të dhe mori Medaljen e Bronztë. Gjithashtu, nëntogeri Hoxha për përkushtimin dhe mesataren e lartë të arritur gjatë kursit u zgjodh "Oficer Kursi Shembullor". Nëntogeri Hoxha ka ndjekur edhe ligjëratat të ndryshme gjatë kursit, që do të jenë shumë të rëndësishme në rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimit të FSK-së.

Ky sukses i nëntogeri Hoxhës dhe oficerëve tjerë të FSK-së, që po shkollohen kudo në botë, janë me rëndësi për ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e FSK-së,

në funksion të përmbushjes së misionit të ri, si forcë ushtarake dhe detyrave ligjore të saj.

Siç kemi shkruar në numrin e kaluar të gazetës "Ushtria" një tjetër përfaqësues i FSK-së, nëntogeri Bener Paçarizi, ka përfunduar me sukses Kursin Bazik për Xhenio Luftarake, në Komandën e Shkollës së Xhenios Luftarake të Forcave të Armatosura të Turqisë në Izmir, pas shkollimit 6 mujor, prej datës 13 janar deri më 3 korrik 2020. Nëntogeri Paçarizi u diplomua me sukses në mesin e 120 kursantëve, ku përveç kursantëve nga vendi pritës, kursin përkatës e ndoqën edhe 13 kursantë nga 7 vende të ndryshme të botës. Ky sukses është edhe një vlerë e shtuar në kapacitetet e FSK-së me kuadro specialistike të nevojshme për ngritjen dhe avancimin e aftësive profesionale të FSK-së në funksion të përmbushjes së misionit të ri si forcë ushtarake dhe detyrave ligjore të saj.

Gjatë tre viteve buxheti dhe rrogat për armatën janë rritur

Ndërsa buxhetet dhe të ardhurat rriten, edhe interesi për të qenë pjesë e Armatës rritet

Anëtarësimi në NATO dhe buxhetet e rritura çdo vit na japin një shans të investojmë shumë më tepër në të gjitha njësitet dhe në pjesë të ndryshme specifike të Armatës sonë. Kemi treguar për tre vjet rresht që buxhetet e mbrojtjes mund të rriten, që do të thotë se mund të sigurojmë kushte më të mira, metoda më të mira pune, -tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, gjatë një vizite tek pjesëtarët e Armatës në Kampin për Trajnime në Ujë të Ohrit.

Shekerinska, -tha se gjatë viteve të kaluara, përqendrimi kryesor ka qenë në gjërat e përditshme, që do të nënkuptojnë jetë – pra, mbi pagat dhe kushtet.

“Pagat në Armatë praktikisht shënojnë rritje çdo vit. Së pari 10 përqind, pastaj 5 përqind, pastaj një rritje për civilët, një 10 përqind shtesë dhe këtë vit kompensimi për qira. Nëse në vitin 2017 një ushtar profesionist sillte në shtëpi 20,000 denarë, sot me rritjen dhe kompensimin, ai sjell në shtëpi më shumë se 31,000 denarë. Kjo është një rritje prej 60 përqind,”-tha ministrja. Shekerinska-shtoi se pagat e civilëve në Armatë, me rritjen e pagës dhe shtesën për kompensim qiraje janë rritur me rreth 70 përqind.

Ndërsa buxhetet dhe të ardhurat rriten, edhe interesi për të qenë pjesë e Armatës rritet. Ministrja informoi se në konkursin e fundit për ushtarë profesionistë për 70 vende, janë paraqitur mbi 700 kandidatë, gjë që mundëson zgjedhjen e më të mirëve dhe më cilësorëve.

Në Kampin për Trajnime në Ujë, ministrja iu referua edhe blerjes së pajisjeve themelore për pjesëtarët e Armatës, uniformat dhe çizmet, për të cilat,-tha ajo,



qëllimi është të realizohet prokurimi i rregullt dhe rinovimi i kësaj pajisje themelore. Ajo shtoi se tre ndërtesa aktualisht janë duke u rikonstruktuar, dhe se rikonstrukcione të tilla do të vazhdojnë, duke pasur parasysh që Armata zotëron ndërtesa të vjetra nga 50 deri në

60 vjet. Shekerinska falenderoi pjesëtarët e Armatës për pjesëmarrjen në aktivitetet lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme dhe u tha atyre se si ushtarë dhe oficerë të NATO-s, prej tyre pritet shumë, por ata me të drejtë do të marrin më shumë dhe më mirë.





Presidenti i Republikës së Maqedonisë Veriore dhe komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë, Stevo Pendarovski, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski vizitoi AP Krivolak dhe rishikoi aktivitetet inxhinierike të kryera në kuadër të projektit për të përmirësuar projektin rrugor: poligoni. Komandantët përgjegjës e njoftuan Presidentin Pendarovski se duke filluar nga 2 muaj më parë, batalioni inxhinierik së bashku me Zyrën për Bashkëpunim Mbrojtës, në Ambasadën amerikane po zbatojnë projekte për riparimin e infrastrukturës ekzistuese rrugore, si dhe për shënjimin dhe prishjen e gjurmëve për rrugë të reja.

Nga gjenerali Gjurginovski dhe komandantët e Komandës së Operacioneve dhe Batalionit të Inxhinierisë, komandanti i Përgjithshëm u njoh me aktivitetet dhe përfitimet e pritura deri më tani, veçanërisht gjatë aktiviteteve stërvitore të një-sive të ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore dhe aleatëve të NATO-s. Gjatë vizitës së AP Krivolak, Presidenti Pendarovski u informua për stërvitjen e ardhshme "Resolute Strike 21", si dhe bashkëpunimin intensiv të Ushtrisë sonë, me Zyrën për Bashkëpunim Mbrojtës në Ambasadën e SHBA. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është dhurimi i materialeve për ndërtimin dhe riparimin e infrastrukturës rrugore në terrenin e trajnimit Krivolak. Kjo, siç theksoi Presidenti Pendarovski, është një përfitim i drejtpërdrejtë i anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO dhe bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara, si një nga partnerët tanë më

Presidenti Stevo Pendarovski në Krivolak

Stërvitja "Resolute Strike 21" në bashkëpunim me amerikanët

Ky është një përfitim i drejtpërdrejtë i anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO

të mëdhenj strategjikë.

Pas turneut dhe njohjes me aktivitetet,, Presidenti Pendarovski theksoi se si shteti i 30-të anëtar i NATO-s, ne kemi diçka për t'u ofruar aleatëve tanë në Aleancë. "Poligoni i stërvitjes Krivolak, në të cilin është investuar shumë në periudhën e kaluar, për të modernizuar vargun e ushtrisë, është një nga burimet tona që mund t'i ofrojmë NATO-s",- shtoi Presidenti Pendarovski.

Anëtarët e Batalionit të Inxhinierisë janë angazhuar në kryerjen e punëve inxhinierike që nga mesi i

